



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 20.02.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin e buxhetit në shpenzime kapitale për sistemin gjyqësor, për vitin 2020”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:06 dhe mbaroi në orën 14:27.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. ***Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
2. ***Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
3. ***Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
4. ***Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***
5. ***Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.***
6. ***Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***
7. ***Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.***
8. ***Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.***
9. ***Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
10. ***Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
11. ***Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***
12. ***Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***
13. ***Gregor Borgowski, EURALIUS.***
14. ***Anisa Kuqi, EURALIUS.***
15. ***Valbona Bala, USAID.***
16. ***Erion Fejzulla, USAID.***

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin e buxhetit në shpenzime kapitale për sistemin gjyqësor, për vitin 2020”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Përshëndetje!

Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 20.02.2020.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës janë 6 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrje e Këshillit.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për detajimin e buxhetit në shpenzime kapitale për sistemin gjyqësor, për vitin 2020”.

Çështje e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për daljen nga përdorimi i aseteve në pronësi të disa gjykatave”.

Çështja e tretë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Dhe shqyrtimi i projektvendimeve (çështja e katërt) për caktimin e gjyqtarës, znj. {...} në skemën e delegimit në Gjykatën e Apelit Korçë dhe për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtarës, znj. {...}.

Çështja e pestë është shqyrtimi i projektvendimit “Për ndryshimin e pjesshëm dhe korigjimin e gabimit në shkrim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 21.01.2020 “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”, përgatitur edhe kjo nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Dhe çështja e fundit është shqyrtimi i projektvendimeve për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet.

Atëherë, lidhur me çështjen e parë e cila ka të bëjë me detajimin e buxhetit në shpenzimet kapitale për sistemin gjyqësor, ftoj zonjën Luljeta Laze të bëjë një raport të projekt-aktit, për mënyrën se si është bërë detajimi i buxhetit.

Fjalën ia kaloj zonjës Luljeta Laze!

**Luljeta Laze:** Përshëndetje!

Në ligjin e buxhetit 88/2019 për buxhetin e vitit 2020 është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2020, pjesë e të cilit është edhe buxheti për sistemin gjyqësor. Buxheti i sistemit gjyqësor është i ndarë në dy programe: Programi planifikim menaxhim, administrim që i përket pjesës së buxhetit që i takon KLGJ-së si dhe buxheti gjyqësor që i takon nevojave për investime për të gjithë gjykatat e vendit.

Krahasuar me kërkesat buxhetore, buxheti i miratuar për sistemin gjyqësor në shpenzime kapitale është pakësuar në vlerën (për të dyja programet) 191,250, përkatësisht në programin Planifikim, menaxhim dhe administrim në vlerën 150,400 mijë lekë dhe në Programin e buxhetit gjyqësor 40,850 mijë lekë.

Fakti që buxheti i akorduar është më i ulët se ai i kërkuar, sigurisht që kërkohej që të bëhej një rialokim i të gjithë nevojave për investime.

Në programin e parë Planifikim, menaxhim dhe administrim, buxheti i akorduar është 49,600 mijë lekë dhe për këtë është një tabelë Pasqyra nr. 1 bashkangjitur, i cili tregon në mënyrë të detajuar se ku janë akorduar, ku janë menduar që të vendosen këto fonde, bazuar tek nevojat që ka KLGJ-ja për funksionimin e saj në mënyrë normale. Dhe këto nevoja kanë shkuar për:

Kompjuter desktop për stafin – 30 copë;

Artikuj të tjerë (sipas Pasqyrës 1 bëhet fjalë), Suiç (Switch) i menaxhueshëm;

Rak (Rack) kabineti;

Suiç (Switch) me 5 porta;

Peçkorda (Patchorda) rrjeti (*përsëritet dy herë*), që janë të përmasave të ndryshme;

Fajëruoll Harduer Cisco (Firewall Hardware Cisco);

Ruter Cisco (Router Cisco);

Rak (Rack) për shpërndarjen e energjisë në të gjitha njësitë;

Të gjitha këto janë realizuar në bashkëpunim të plotë me Sektorin e IT-së dhe janë nevoja të domosdoshme për të garantuar funksionimin e pjesës elektronike në godinën e

re.

Gjithashtu është marrë në konsideratë nevoja për një projektor profesional dhe një stendë e palosshme me pult (kjo është e thënë në mënyrë të detajuar) dhe ky projektor shërben për nevoja gjithashtu të funksionimit të KLGJ-së.

Laptop Advanc, ky laptop (keni kërkuar shpjegime), do jetë një laptop i lëvizshëm i cili plotëson nevojat që mund të kenë komisionet, hedhja e shortit dhe nevoja të tjera të lëvizshme, domethënë që kur ka nevojë çdo pjesë e.. apo trajnime të ndryshme që mund të bëhen, pra për të gjitha nevojat kemi një laptop i cili do të plotësojë të gjitha këto nevoja.

Gjithashtu sistem audio-video për sallën e mbledhjeve. Kjo ka qenë një nevojë prioritare për godinën e re, e cila nuk do të plotësohet më sipas komunikimeve që kemi pasur me AKSH-in. Fillimisht kjo ishte një nevojë që do të mbulohej nga AKSH-i. Me marrjen e njoftimit në shtator që kjo nuk do të plotësohet më nga AKSH-i, sigurisht që dilte prioritare për zhvillimin e mbledhjeve.

Gjithashtu, Sektori i IT-së ka përcaktuar edhe nevoja të domosdoshme që këto të funksionojnë, siç janë UPS i përgjithshëm, gjenerator, për të garantuar një fuqi të dytë, një burim të dytë energjie, si dhe për të mbajtur dhe për të garantuar energjinë e pandërprerë të serverit qendror.

Sistemi i qarkullimit të dokumentave, edhe ky është bërë një vlerësim i detajuar nga sektori i IT-së.

Derë detektimi: 1. Për sa i përket hyrjes për pjesën e KLGJ-së si dhe diferenca, pajisje të ndryshme, e kemi lënë të padetajuar për shkak se me vendosjen në godinën e re, mund të dalin nevoja të paparashikuara dhe të cilat do detajohen këtu në të gjitha rastet kur të jetë e nevojshme.

Kjo është për sa i përket nevojave të KLGJ-së.

Për sa i përket nevojave të tjera për buxhetin gjyqësor, sigurisht që është bërë një punë 1-vjeçare, që nga momenti i parë kur fillon procesi i projektbuxhetit e deri në momentin e fundit kur marrim në konsideratë buxhetin që akordohet. Kjo bëhet bazuar tek kërkesat që gjykatat paraqesin bazuar tek i gjithë databeji (*database*) që specialistët e

kësaj strukture disponojnë për gjendjen e gjykatave, si për nevojat për pajisje elektronike, për pajisje të tjera të nevojave të ndryshme që gjykata ka, por jo vetëm kaq, edhe për të gjithë nevojën tjetër që mund të ketë për godina dhe për mirëmbajtjen e tyre. Bazuar në të gjitha këto nevoja dhe pas një rishikimi të plotë, pas një rishikimi që i është bërë në funksion të buxhetit të miratuar, kemi një pasqyrë të cilën mund ta shpjegojmë në mënyrë të detajuar (Pasqyra nr. 2).

Atëherë, në kolonën e parë është ku është vendosur projekti. Dua t'ju bëj me dije që për Gjykatën e Lartë ka qenë gjatë gjithë procesit të projektbuxhetit deri në fund, është i nevojshëm për t'u bërë projekti paraprakisht për dhomën e serverit. Gjithashtu është vendosur një fond për Gjykatën e Rrethit Durrës dhe për Gjykatën e Rrethit Fier. Shpjegimet për këto janë: Gjykata e Rrethit Fier është pjesë e të gjithë procesit të projektbuxhetit dhe përveç projektit janë parashikuar edhe fondet në rikonstruksion, bëhet fjalë për rikonstruksionin e gjithë rrjetit elektrik të saj. Kemi edhe një rekomandim nga autoriteti përkatës, pasi një vit më parë, në këtë gjykatë pati një incident e rrjetin elektrik. Pra është i domosdoshëm. Kemi marrë të gjithë dokumentacionin, pasi ajo u verifikua atje dhe rekomandohet në mënyrë të qartë që të bëhet rrjeti elektrik. Kështu që nuk mund të shmangeshim nga kjo gjë.

Për sa i përket Gjykatës së Rrethit Durrës, Gjykata e Rrethit Durrës është nga ato gjykata që është e domosdoshme për t'u ribërë dhe ka qenë vazhdimisht në të gjitha planet dhe projektet, që ajo të bëhet nga e para. Jemi në situatën që për këtë gjykatë është dhënë edhe nga Bashkia një shesh ndërtimi dhe gjatë kohës që ka qenë, sikurse e përmenda pak edhe herën e kaluar, lëvizja e kryetarëve të gjykatave ka pasur një rol në drejtim të kryerjes dhe realizimit të investimeve, sidomos për sa i përket pjesës së ndërtimeve, pasi kryetari i gjykatës është shumë aktiv dhe mbulon një pjesë të madhe të detyrave në pjesën e bashkëpunimit që duhet për t'u realizuar kjo gjë. Meqenëse nuk është më kryetarja dhe ajo ka pasur disa bashkëpunime për të bërë edhe projektin ndoshta me fonde të tjera, ne mendojmë që pavarësisht hartës së re gjyqësore, mendojmë që Gjykata e Durrësit është nga ato që do qëndrojnë dhe kemi lënë një fond projekti në mënyrë që të bëhet projekti sivjet dhe ndoshta nga viti tjetër, kur do jemi të qartë edhe për

hartën e re gjyqësore, të fillojmë të paktën ndërtimin e një godine të re, pasi sikurse dihet, ka shumë nevoja për ndërtimin e godinave.

Tek pjesa e rikonstruksionit, sikurse shihet është vendosur vetëm një fond që ka të bëjë me Gjykatën e Apelit Durrës për 2.800.000 lekë. Tani këtu do ndalesha pak. Pse e kemi lënë në këtë? Dhe ka të bëjë për rikonstruksionin nga tërmeti.

Në fakt ne kemi një informacion të detajuar për të gjithë gjykatat që kanë nevojë për riparimin e dëmeve nga tërmeti. Disa prej tyre edhe kanë bërë procesin e tërë dhe kanë kalkuluar edhe nevojën konkrete që ato kanë me një studio ligjore, në një studio profesionale.

Gjykata e Durrësit, sikurse shihet një kolonë më tutje, ka pasur gjatë gjithë procesit të projektbuxhetit, ka kërkuar dhe ka të argumentuar një kërkesë për 11.200.000 lekë, për nevoja të tjera të rikonstruksionit të godinës dhe meqenëse kjo gjë ka qenë e parashikuar dhe ne menduam që kjo t'i kalojë, vendosëm edhe një detajim për rikonstruksionin nga tërmeti, me qëllim që, zakonisht, kur fillohet të bëhet një rikonstruksion, ai bëhet i plotë dhe për rastin konkret gjykata e ka të nevojshme që të bëjë edhe dëmet nga tërmeti dhe është e vetmja nga dëmet nga tërmeti që ne e kemi detajuar/programuar me buxhetin tonë, me qëllim që dihet gjendja që është, të fillojë sa më parë dhe që gjykata të krijojë kushtet që të kthehet në godinën e saj.

Për sa i përket godinave të tjera, nuk kemi alokuar fonde për dëmet nga tërmeti, për shumë arsye. Një nga arsyet është që, sikurse jemi në dijeni, Ministria e Drejtësisë ka qenë aktive në këtë proces dhe i ka dërguar nevojat në Ministrinë e Infrastrukturës për rindërtimin që është vendosur dhe ndoshta pritet që të merren fonde prej andej dhe do një akordim të dytë.

Veçuam apelin Durrës, meqenëse ajo e ka një fond edhe më të madh sesa pjesa që ka evidentuar për dëmet nga tërmeti, me qëllim që ajo të fillojë punën sa më parë të jetë e mundur.

Për sa i përket gjykatave të tjera, për çështjen e rikonstruksioneve, shifrat në përgjithësi janë të ulëta dhe kanë të bëjnë me mirëmbajtje të domosdoshme, se pavarësisht faktit do qëndrojnë apo jo, nuk mund të lihen që të degjenerojë gjendja e

gjykatave, kështu që në përgjithësi, kërkesat e tyre janë të argumentuara, janë të programuara që në mars të vitit të kaluar dhe sikurse shihet, vlera më të mëdha është Gjykata e Fierit (sikurse e shpjegova, ka të bëjë me rrjetin elektrik) dhe Gjykata e Tiranës, edhe kjo ka rrjetin elektrik, rrjetin kompjuterik dhe të gjithë këtë shifër që ka këtu e ka pasur të programuar që 1 vit më parë, por nuk arriti dot të realizonte procedurat e prokurimit. Dhe aty le të themi që disa lëvizjet e titullarëve të institucioneve kanë ndikuar ndoshta edhe në këtë drejtim.

Ky është programimi që kemi bërë.

Veçanërisht do të përmendja këtu Gjykatën e Posaçme, të cilat një pjesë të kërkesave nuk kanë qenë të programuara që prej fillimit, por gjatë procesit, në fund, ato kanë sjellë disa kërkesa të reja që kanë të bëjnë me krijimin e një dhome sekrete për marrjen e vendimeve për përgjimet paraprake, e cila ka detajuar në mënyrë të qartë se çfarë kërkesash ka dhe si duhet të jetë kjo nevojë, dhe e përlllogaritur së bashku me gjykatën por edhe me specialistët këtu, jemi munduar dhe pavarësisht i kishim programuar apo jo, ne i kemi përfshirë në programimin tonë nevojat që këto gjykata kanë patur.

Gjithashtu, pajisje të tjera, pajisje mobilie ku përfshihen edhe pajisje të tjera, zëri është pajisje mobilie, por përfshihen edhe pajisje të tjera që kanë të bëjnë me nevojat që gjykatat kanë për zëvendësim, qoftë të pajisjeve për sallat e gjyqit, për zyrat (atje ku është e nevojshme), por edhe për pajisje të tjera që kanë të bëjnë me nivelin e sigurisë në gjykata: ku ka zëvendësim të kamerave kur ato kanë mbushur afatin, për sa i përket sistemeve të sigurisë. Janë kërkuar disa hyrje të limituara, vendosja e sistemeve të limituara në gjykata, etj.

Për sa i përket pajisjeve elektronike, doja ta theksoja këtë që bëhet një punë jashtëzakonisht e mirë. Keni në mënyrë shumë të detajuar për çdo gjykatë nevojën që do të realizohet, në numër kompjuterash, serverësh (kur është e nevojshme për t'u zëvendësuar) dhe bazuar tek databeji (*database*) që punonjësit këtu kanë, specialistët e fushës, edhe në ato raste kur gjykatat nuk janë të vëmendshme dhe nuk e kanë kërkuar në mënyrë të plotë nevojën, është korrigjuar nevoja nga specialistët që struktura jonë ka,



specialistët elektronik.

Pak a shumë kjo është në vija të përgjithshme.

Nëse ka ndonjë pyetje?

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Laze për relatimin e detajuar.

Atëherë fjalën po ia lë anëtarëve nëse kanë paqartësi, sugjerime lidhur me shpërndarjen e investimeve.

Po, zoti Muharremaj!

**Erjon Muharremaj:** Faleminderit!

Kisha një pyetje ju lutem në lidhje me rikonstrukcionin e godinës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pasi së bashku me Gjykatën e Apelit Durrës edhe ajo është e dëmtuar dhe nga Instituti i Ndërtimit është shpallur si godinë e pabanueshme. Nuk është planifikuar për shkak se presim një vendimmarrje nga ana e Ministrisë së Financave në lidhje me rikonstrukcionin e godinës, nëse ju kuptova drejt? Faleminderit!

**Luljeta Laze:** Në fakt, do të thoja që kemi një dosje shumë të detajuar, për aq sa informacion kemi marrë deri tani për gjykatat ose godinat që janë dëmtuar nga tërmeti. Gjykata e Lezhës e ka përfunduar tani para dy ditësh ekspertizën finale dhe ne nuk mund të jemi në situatën që të mos të detajojmë investimet, pasi lidhet edhe me një sërë procesesh të tjera. Ndoshta erdhi rasti se më doli nga vëmendja për të thënë që kemi një fond rezervë prej 48 milion lekësh, të cilën e kemi të pashpërndarë. Pikërisht ishte e vendosur tek kolona e dëmeve nga tërmeti (në qoftë se do ta shikoi aty në fund), dhe neve e kemi mbajtur të pashpërndarë këtë sepse është shumë e paqartë se sa do të kushtojë secila prej tyre dhe me vendimet e qeverisë që kanë dalë dhe me udhëzimet përkatëse, ka një sërë detajesh se si do të bëhen, nuk është edhe vetëm puna se sa kushton, por edhe se si duhet të bëhet procedura, se si duhet të bëhet riparimi i dëmeve. Nga ana tjetër, sikurse ju thashë, jemi në një proces miks këtu dhe duhet që ta sqarojmë nëse të gjitha këto fonde, dhe ne jemi të interesuar, do të na jepen nga Ministria e Infrastrukturës për rindërtimin, ne sigurisht që jemi të interesuar që këto fonde t'i marrim plus. Dhe derisa të sqarohet e plotë situata, ne nuk e kemi shpërndarë. Kemi një fond rezervë. Nuk jemi të sigurt që ajo mund të shërbejë për të gjitha gjykatat dhe për të gjitha nevojat që janë për

riparimin e dëmeve, kjo mund të jetë një vendim i dytë, pasi të sqarohet situata dhe fondet që mund të marrim dhe fondet që ne kemi në dispozicion apo edhe të tjera gjëra. Për Lezhën unë e kam marrë informacionin tani para dy ditësh, ekspertizën më të fundit që i është bërë.

**Brunilda Kadi:** Faleminderit!

Atëherë, unë kam disa pyetje për t'u sqaruar, për të kuptuar çfarë janë këto detajime.

Në radhë të parë po pyes për sistemin e qarkullimit të dokumentave. Mund të sqaroni edhe një herë çfarë është kjo sepse është edhe një vlerë e konsiderueshme?

**Luljeta Laze:** Kemi një studim shumë të detajuar të punonjësve për shkak të kësaj nevojë që lindi, e cila edhe është e qartë që është një nevojë për ta automatizuar dhe për ta saktësuar çështjen e qarkullimit të dokumentacionit në një institucion, por aq më tepër këtu edhe u evidentua qartë kjo kur ishte çështja e dokumentave që ishin tek inspektorët. Pra ishte një problem i dytë që ishte e qartë që dokumentat nuk ishin të evidentuara, të kthyera në arkivë, e me radhë.

**Brunilda Kadi:** Më fal Luli! Ka ndonjë nga ata të IT-së këtu që mund të na i shpjegojë? Është sistem IT-je?

**Luljeta Laze:** Po, po!

**Brunilda Kadi:** Atëherë, është një lloj Intranet-i?

**Luljeta Laze:** Po!

Jo, nuk është Intranet. Është një soft. Është një soft i cili garanton... atëherë, ka edhe me fjalë sqarimet prej tyre, dhe thuhet "Në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të proceseve të punës, përmes sistemeve të automatizuara informatike, me krijimin dhe konstituimin e institucionit të ri të qeverisjes së gjyqësorit, Këshillit të Lartë Gjyqësor, u pa i nevojshëm edhe pajisja me një sistem elektronik i menaxhimit të dokumentave, rekordeve dhe të protokollit, i cili ka për qëllim të ofrojë një platformë të unifikuar për menaxhimin dhe organizimin e arkivës, punës dhe materialeve që shkëmbehen dhe kontrollohen gjatë aktivitetit të përditshëm të punës".

**Brunilda Kadi:** O Luli, është soft-është soft.

*(Ripërsëritet që është një soft.)*

Është një soft. Që duhet?

**Luljeta Laze:** I cili realizon shpërndarjen dhe gjetjen e shpejt të dokumentacionit, centralizimi i arkivimit, i protokollimit, aksesimit, siguri dhe kontroll, proces më i shpejt i vendimmarrjes (ndihmon kjo gjë), bazuar edhe në statistikat, një sistem i menaxhimit të dokumentacionit mund të reduktojë koston e përpunimit të dokumentacionit në 80%. Dhe në mënyrë të detajuar përmban...

**Brunilda Kadi:** Po, po, po! E kam parë, s'ka gjë.

Atëherë, prandaj doja që të ishte ndonjë nga të IT-së këtu për ta pyetur sepse siç e dini ne kemi ngritur një grup pune që po merret me draftimin e rregullores së brendshme dhe në një nga pikat që po diskutojmë është pjesa e aksesit të dokumentacionit që hyn në Këshill për të gjithë anëtarët dhe pastaj për pjesën tjetër si do jetë, rast pas rasti, nevoja. Dhe ajo që është menduar, tek grupi që po punojmë, është ndoshta nevoja e një softi të tillë, që të krijojë, nuk e di tani nga ana e gjuhës teknologjike si mund të quhet, një lloj Intranet-i apo ky softi që mendohet mund ta bëjë këtë gjë që çdo dokument që hyn në Këshill, të themi, të depozitohet diku dhe pastaj të jetë i aksesueshëm për anëtarët, i lexueshëm për një pjesë tjetër, e kështu me radhë. Pra unë doja t'ia bëja këtë pyetje sepse përderisa do harxhohen lekët, a e mbulon këtë gjë për shembull ky softi ose kur të vijë puna që të bëhen specifikimet, kur të ekzekutohet, mund ta përfshijë këtë gjë?

**Luljeta Laze:** Edhe një herë dua ta përsëris, që në fakt ato kanë disa muaj që punojnë për këtë dhe për aq sa ne, edhe ne i kemi pyetur në mënyrë të detajuar, kështu sikurse edhe ju po pyesni, ajo që na është thënë është që çdo dokument që hyn, regjistrohet, është e qartë se ku shkon dokumenti, kanë akses për të parë dokumentin dhe aksesin vendoset nga softi, sipas rastit.

Po, patjetër! Unë mendoj që mund ta bëjë.

Megjithatë, meqenëse është një pyetje shtesë, ne thjesht mund ta marrim si pyetje dhe ajo që unë doja të thoja është kjo... *(ka një interferencë në mikrofonin e zonjës Luli).*

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Ideja është që mund të jetë. Pra, teknologjikisht mund ta

përfshijmë këtë gjë.

**Luljeta Laze:** Po!

Dhe specifikisht kjo për anëtarë... por unë mendoj që sikurse – tani, pa paragjykuar asgjë – sikurse ka akses të limituar sipas niveleve, për të parë dokumentacionin, kjo besoj që është e përfshirë. Por nëse do këtë ndonjë gjë shumë specifike, të veçantë, neve edhe mund ta shtojmë.

Dhe sikurse ju thashë, kemi poshtë një fond të papërdorur. Pasi ta diskutojmë veçmas këtë gjë, qoftë edhe me grupin e IT-së edhe me kërkesën që ju parashikoni dhe në qoftë se nuk është e përfshirë, ne mund të ndryshojmë vlerën më pas.

**Erjon Muharremaj:** Meqë tani u sqarova që bëhet fjalë për një softuer (*software*), do ju lutesha që të merrni në konsideratë faktin që softuerët ndryshojnë vazhdimisht nga viti në vit sepse dalin versione më të avancuara. Përderisa bëhet fjalë për softuer (*software*), ndoshta harxhimi i një shume të tillë prej 80.000 euro, për afërsisht me kursin e sotëm të këmbimit, mos do ishte më mirë që softi, nga ata që e ofrojnë, të merrej me qira për një shumë shumë herë më të vogël dhe në vitin e ardhshëm përfiton versionin e përditësuar të tij?

Këtë sqarim ndoshta mund të na e jepnin specialistët e IT-së. Faleminderit!

**Luljeta Laze:** Sigurisht që kjo është një alternativë që ju po jepni. Ne po e mbajmë shënim. Por ne do thonim që kur është ndërtuar kjo, janë marrë eksperiencat edhe në institucione të tjera. Dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjithashtu ka një soft të vetin që përdor për dokumenta, për qarkullimin e dokumentave të brendshëm. Kuvendi më duket e kishte gjithashtu një soft; dhe përveç softit përfshihen edhe disa... të specifikuar janë... edhe disa zëra të tjerë le të themi, që unë nuk jam në gjendje t'i shpjegoj një nga një, por që në mënyrë të detajuar ata shpjegojnë se pse kjo e gjithë përfundimi i kësaj pune kushton kaq.

**Brunilda Kadi:** Pyetja ishte: Mos duhet të pyeten IT-të, që del është me më leverdi ekonomike që ta marrim me qira, meqenëse është edhe kjo karakteristika që teknologjia ndryshon shumë shpejt.

Tani, kjo ishte mirë të ishte këtu sepse ne s'ka kuptim të marrim vendimin tani

dhe pastaj diskutimin më vonë.

Okej, në kuadër të kësaj, të vazhdoj unë ndoshta, se s'kemi çfarë diskutojmë këtu?!

Thjesht edhe unë dua të evidentoj edhe disa gjëra të tjera.

Në këtë drejtim që diskutoi edhe Erjoni, unë kisha për shembull për kompjuterat desktop. Thuhet që janë 30 copë. Dhe me sa kam unë informacion, ka vite që qarkullon teknologjia që nuk merren 30 njësi qendrore. Merren 30 ekranë dhe 1 njësi qendrore që kushton të paktën 80% më pak e kësaj shumës. Pra në qoftë se ti do marrësh 30 kompjutera me 800.000 lekë të vjetra për kompjuter, ti mund të marrësh 30 desktop (ekrane pra) dhe 1 njësi qendrore që mund të kushtojë, mund të zër 100.000 lekë një nga ato kompjuterat. Dhe unë kërkoj patjetër që kjo të verifikohet dhe t'i kërkohet IT-ve dhe të shihet sepse është një diferencë shumë e madhe dhe për më tepër ka edhe probleme me ambientin, se s'kemi pse të kemi 30 njësi (që ato kanë probleme edhe shëndetësore, etj., etj.), kur mund të jetë 1 njësi. Pra është një zgjidhje teknologjike shumë herë më e lirë dhe efikase. Thjesht e thashë si sugjerim këtë.

Tani kam edhe dy pyetje të tjera që lidhen, për ta kuptuar.

Kur flitet për godinën, kam përshtypjen që këto pajisje që parashikohen janë për godinën e re? Pra gjeneratori edhe dera e detektimit.

Tani, kjo e para njëherë, gjeneratori do jetë vetëm për pjesën që do administrojë Këshilli i Lartë Gjyqësor apo për të gjithë godinën?

**Luljeta Laze:** Për gjeneratorin, treguesit teknik janë marrë nga projekti i godinës, sepse nuk mund të... gjërat shkojnë për pasojë nga njëra-tjetra. Nuk mund të shpiken. Ajo që doja të thoja njëherë për gjeneratorin është që është duke u ngritur me sa ne jemi në dijeni (por verbalisht) një njësi, një ndërmarrje (nuk e di, me kapital tërësisht shtetëror apo sh.a.), e cila do marrë në përgjegjësi administrimin e të gjithë godinës dhe ka shumë mundësi që edhe gjeneratori të jetë, të mund të blihet nga ata. Ne sigurisht që do jemi në pritje.

Nëse, do blihet nga ata, sigurisht që nuk do blihet nga neve.

Por, që gjeneratori është jashtëzakonisht i domosdoshëm dhe nuk mund të ketë

një godinë e atij niveli pa një burim të dy energjie, kjo nuk bëhet fjalë.

**Brunilda Kadi:** Jo, pyetja ime ishte, -do jetë për të gjithë godinën?

**Luljeta Laze:** Dhe.. Ja po ta them!

Dhe përveç burimit të dytë energjie në tërësi për të punuar për funksionalitetin, është i domosdoshëm edhe për mbajtjen në punë të serverit qendror, ku do jetë të gjitha të dhënat.

Tashti, pjesa është që, patjetër që është për të gjithë godinën sepse nuk mund të ndahet në dy-tre gjeneratorë.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Luljeta Laze:** Jo, nuk është e ndarë sepse gjeneratori...

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Luljeta Laze:** Kam pyetur unë, bazuar edhe tek pyetja juaj... kërkon trefazor. Mund të ndahen këto pjesët e tjera të shpenzimit të energjisë, që kërkojnë vetëm një fazë (më shpjegoi inxhinieri të paktën që kemi këtu), ndërsa gjeneratori është e pamundur që të ndahet. Nuk mund të ketë disa gjeneratorë në një godinë të atij niveli.

**Brunilda Kadi:** E kuptoj! Por pse duhet ta bëjmë ne shpenzimin dhe jo dy institucionet e tjera? Se është edhe KLP-ja, është edhe Shkolla e Magjistraturës. Pse duhet ta bëjmë ne këtë shpenzim?

**Luljeta Laze:** Sepse ne e kemi menduar që ta programojmë këtë gjënë. Pastaj, në qoftë se juve mendoni që nuk është i nevojshëm dhe...

**Brunilda Kadi:** Jo, jo! I nevojshëm mund të jetë, por pse duhet ta paguajmë ne dhe jo dy institucionet e tjera, ose të paktën të ndahen nëse ekziston.

**Luljeta Laze:** ...kur të lindin nevoja të tjera, ne jemi shumë gati që t'ju themi, -ne kemi bërë këtë shpenzim, ju mund të bëni një shpenzim tjetër.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Luljeta Laze:** Atëherë, të gjitha këto që unë përmenda, edhe salla, sistemi audio-video për sallën e mbledhjeve edhe gjeneratori kanë qenë...

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Salla do jetë e njëjtë?

**Luljeta Laze:** ...kanë qenë të programuara që do kryheshin nga AKSH-i.

Sallën tonë, sallën tonë.

Por kanë qenë të programuara që do kryheshin nga AKSH-i, dhe në momentin që AKSH-i na ka sjellë shkresë në shtator që nuk i bën më, sigurisht që ne do marrim masat për të programuar.

**Brunilda Kadi:** E njëjta histori është edhe për detektorin? Edhe detektori do jetë i njëjtë?

**Luljeta Laze:** Detektori është vetëm një, vetëm për hyrjen tonë.

**Brunilda Kadi:** Domethënë, KLP-ja dhe Shkolla e Magjistraturës do kenë detektorë më vete?

*(Zonja Laze flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Luljeta Laze:** Do kenë hyrje tjetër.

**Brunilda Kadi:** Kanë hyrje më vete. Okej!

Atëherë, unë këtu dua shpreh një konsideratë timen. E vlerësoj që, përveçse ne nuk kemi pse të bëjmë shpenzim për dy institucione të tjera, mendoj që aq sa është emergjente dhe e domosdoshme, mund të alokohet një shumë shumë herë më e vogël dhe të bëhet një gjenerator vetëm për sallën e mbledhjeve sepse nga gjendja e sistemit të energjisë elektrike që kemi sot ne nuk kemi raste që na ikin shpesh dritat dhe nuk është se bëhet ndonjë dëm i rëndë dhe i pazëvendësueshëm në qoftë se ikin në të gjithë godinën, por për sallën e mbledhjeve plenare, e cila regjistrohet audio dhe është një akt që është i pazëvendësueshëm (procesverbali), mendoj që të ketë një gjenerator për sallën dhe të planifikohet një shumë shumë herë më e vogël, që e administrohet apo s'do administrohet nga kjo shoqëria që mendohet se do ngrihet, ne gjithsesi ta kemi këtë shpenzim, dhe sugjeroj që të hiqet si shpenzim, përveç arsyes së parë që thashë që s'kemi pse e paguajmë ne një pajisje që do i shërbejë edhe dy institucioneve të tjera.

Po kështu kam një mendim edhe për detektorin, ndoshta, duke qenë se vetë ju e thatë që fondi është shumë herë më i shkurtuar nga ajo që ne kemi nevojë dhe prisnim, ndoshta nuk është një emergjencë detektori, se deri tani nuk kemi parë ndonjë situatë që të na jetë dukur i domosdoshëm detektori. Ja ku e kemi. Asnjë nuk kalon tek detektori.

Edhe këtë e sugjeroj si shpenzim që të hiqet. Pra gjeneratori të jetë një shumë shumë herë më e vogël. Detektori le të rrijë si fond. Në fund pastaj, nëse ne nuk do na dalin situata më emergjente dhe më të domosdoshme, mund të marrim atë vendimin tjetër që bëhet në fund të vitit para se të përfundojë periudha e, se nuk e kam mirë parasysh tani atë termin ekonomik; edhe kjo e kompjuterëve kisha.

Dhe të fundit, - me fal Erjon, -të fundit e kisha në lidhje me këto investimet nëpër strukturat e gjykatave. A është, le të themi, në kohën e duhur planifikimi i këtyre, kur ne po presim dita-ditës të miratojmë hartën dhe do kemi një ide më të qartë pastaj për godinat? Kjo gjëja është patur parasysh? Për shembull për Durrësin që është llogaritur 100 milion lekë të vjetra, edhe sikur të rrijë Durrësi si gjykatë, sipas projektit të ri, a është ajo një godinë që ia vlen të investosh këtë shumë.

*(Zonja Laze dhe pjesëtarë të tjerë të stafit flasin pa ndezur mikrofonat.)*

Kjo shifra është vetëm për projektin!

*(Zonja Laze flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Luljeta Laze:** Po! Që të bëhemi të gatshëm që një vit përpara...

**Brunilda Kadi:** Okej, por edhe projekti që do kërkohet, me çfarë ideje; për çfarë gjykate; për çfarë kapaciteti do kërkohet pa u bërë harta?

*(Zonja Laze dhe pjesëtarë të tjerë të stafit flasin pa ndezur mikrofonat që do pritet harta.)*

Okej, mirë! Këtë e kisha si pyetje.

Okej, në rregull! Këto kisha unë si sugjerime dhe pyetje. Faleminderit!

**Luljeta Laze:** Për sa i përket si derës së detektimit edhe gjeneratorit, ne programojmë sipas disa standardeve të caktuara, pavarësisht faktit ka ndodhur gjë, s'ka ndodhur gjë, unë nuk mund ta marrë unë përsipër këtë e të them që meqenëse nuk ndodh gjë... Ju e dini shumë mirë që në çdo vend që keni shkuar jashtë, boll kanë shkuar të gjithë, nuk ka institucion, edhe të vogël edhe jo aq të rëndësishëm që të mos i ketë disa standarde të caktuara. Kështu që ne po flasim për disa standarde. Në qoftë se do çdojmë nga standardet pastaj është tjetër gjë, dakord. Vendimi juaj është.

**Erjon Muharremaj:** Në lidhje me çështjen e detektorit tek dera, ka një problem.



Është e vërtetë ajo që thoni juve që në të gjitha institucionet ka kontrollues të tillë tek hyrjet. Problemi është që në atë godinë ku do të vendosemi neve, hyrja jonë nuk është e vetmja dhe hyrja aktualisht në Shkollën e Magjistraturës, që është pjesë e të njëjtës godinë, nuk ka një kontrollor të tillë. Sa vlerë do të ketë dera që do të montojmë neve, kur mund të futen nga ana tjetër e godinës, ku nuk ka asnjë lloj kontrolli. Domethënë, ky investim që do bëjmë neve është krejtësisht i pavlerë sepse aktualisht Shkolla e Magjistraturës nuk ka kontrollues. Që do të thotë, duhet koordinuar me dy institucionet e tjera me të cilët ne do të ndajmë bashkërisht godinën, përpara se ne të vendosim të bëjmë investime të tilla. Nëse e bëjmë ne investimin dhe ata nuk e bëjnë, investimi ynë është krejtësisht i pavlerë. Janë para të hedhura dëm. Është e njëjta godinë dhe nga ajo hyrje mund të futesh andej. Faleminderit!

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

**Luljeta Laze:** ... Edhe sikur, ne të bëjmë tonën dhe do t'u themi atyre që të shtojnë, të bëjnë edhe ata pjesët e tyre. Kjo s'do me thënë që meqë ata s'bëjnë, ne s'bëjmë.

**Xhevdet Haxhiu:** Në lidhje me gjeneratorin – sepse jemi marrë shumë mbas anës, shtyrjes së mbledhjes, jemi marrë shumë me këtë punën e gjeneratorit – është e pamundur ajo që propozon Bruna që të vesh vetëm një gjenerator për sallën e mbledhjeve. Ne jemi këtu në një godinë shumë më të vogël, me një sipërfaqe shumë më të vogël, me fuqi shumë të vogël të pajisjeve elektrike dhe elektronike që kemi dhe kemi një gjenerator goxha të madh që është jashtë dhe ai gjenerator është edhe me dy linja elektrike të tjera, për të garantuar funksionimin normal të institucionit. Ndërsa atje, çdo gjë do jetë me energji elektrike. Ngrohja do jetë me energji elektrike, ambientet do jenë me energji elektrike, serveri qendror që është një kërkesë e AKSH-it në takimet që kemi qenë së bashku me zotin Muharremi, më falni...

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Serveri normal që do ketë gjenerator.

**Xhevdet Haxhiu:** Së bashku me z. Muharremaj dhe me Sekretarin e Përgjithshëm, kemi qenë në dy-tre takime tek AKSH-i, të cilës na është kërkuar me të madhe pasja e

gjeneratorit.

**Brunilda Kadi:** Nuk diskutohet gjeneratori i serverit. As që diskutohet fare. Ai është i pari.

**Xhevdet Haxhiu:** Po si? Një gjenerator për serverin, një për sallën e mbledhjeve, një për ngrohje?

**Brunilda Kadi:** Një të vogël pra. Një gjenerator me kapacitet më të vogël që të... Një të vockël. Quajeni edhe të vockël. S'ka problem.

**Xhevdet Haxhiu:** Këtë e ka përllogaritur...

*(Ndërhyn zonja Laze, ndërkohë që flasin z. Haxhiu dhe znj. Kadi dhe ka mbivendosje të fjalëve.)*

**Brunilda Kadi:** ...Meqë ju duket humoristike, mund ta quani edhe të vockël.

**Xhevdet Haxhiu:** S'po them unë humoristike.

**Brunilda Kadi:** Jo, po e them unë, meqë dëgjova komentet që mund të jetë i vockël. Quajeni edhe të vockël.

Ideja është që ne nuk kemi luksin që të marrim gjenerator për të gjithë godinën, kur nuk e kemi ne të gjithë godinën dhe s'kemi nevojë të marrim për ngrohje gjenerator sepse nga ajo që kemi parë deri tani, nuk na kanë ikur ndonjëherë dritat. Ne i kemi muret po na çahen e po na bien në tavolinë dhe s'po alarmohemi ose ikën dritat e s'u ngrohëm dot gjysmë ore. Unë po them, të ketë për sallën e mbledhjeve dhe për serverin. Pyesni ata që merren me këtë punë dhe t'ju japin një shifër tjetër dhe mos të merret gjeneratori tani, se nuk jemi në ato kushte. Kemi të tjera prioritete. Kjo ishte ajo që propozova unë. Nuk përmendi njeri serverin. Mendoj që vihet në fillim ai, pastaj çdo gjë tjetër. Serveri nuk diskutohet fare që duhet të ketë gjenerator. Kështu që mos u mundo të japësh argumenta për serverin.

**Naureda Llagami:** Atëherë, diskutime të tjera?

**Luljeta Laze:** Unë doja të sqaroja edhe diçka lidhur me godinat.

Doja të sqaroja lidhur me investimet për gjykatat.

Në qoftë se shikohet, pikërisht për shkak të faktit që do bëhet harta e re gjyqësore, nuk kemi parashikuar as ndërtim dhe as rikonstruksion të plotë për godinat e reja të

gjykatave, megjithëse ato kanë goxha nevoja. Pikërisht jemi në pritje të kësaj. Kurse për sa i përket nevojave minimale që kanë për mirëmbajtjen e tyre, ato janë të domosdoshme dhe nuk mund të çedohet nga ajo, se në fund të fundit, deri në momentin që do ketë një ristrukturim të ri të situatës për numrin e gjykatave, ato janë gjykata dhe duhet të jenë të tilla.

**Maksim Qoku:** Si anëtar aktiv të grupit në grupin e hartës, i kam ndjekur me kujdes dhe kam parë që janë vetëm shpenzime emergjence që nuk kanë të bëjnë me.. Kështu që nuk kanë lidhje, nuk e cenojnë atë çka ne marrim përsipër në hartë.

**Naureda Llagami:** Atëherë, për të vijuar.

Kalojmë në votim propozimet e bërë nga Bruna duke qenë se ka bërë...

*(Zonja Kadi kërkon fjalën për ta riformuluar.)*

Riformulon vetë ti atëherë.

**Brunilda Kadi:** Atëherë, unë, tek tabela, tek pasqyra e parë propozoj që shuma e parashikuar për kompjutera nga 2.400 mijë lekë, -kështu lexohet ajo?

*(Nga salla, përgjigjen -Po!)*

Të jetë jo më shumë sesa gjysma e kësaj.

*(Disa nga anëtarët dhe pjesëtarë nga stafi flasin pa ndezur mikrofonat.)*

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Se ka 20 vjet që ekziston kjo teknologjia.

*(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

**Brunilda Kadi:** Atëherë, një sekondë. Një sekondë.

Atëherë, duke qenë se anëtarët e tjerë mund të votojnë kundër, pro për secilin nga zërat, atëherë unë propozoj që për secilin propozim të hidhet në votim, se ndoshta s'ka kuptim pastaj votimi.

Për shembull, për zërin “kompjuter desktop – 30 copë, çmimi 80 lekë, vlera 2.400 lekë, 2.400 mijë lekë”, unë propozoj që kjo shifra, për arsyet që thashë në fillim të diskutimit tim, të jetë sa gjysma e kësaj.

**Dritan Hallunaj:** Pse sa gjysma dhe jo më pak?

**Brunilda Kadi:** Sepse... Okej! Meqenëse Tani po pyet pse sa gjysma e jo më pak,

unë bëra një arsyetim. Nga informacionet që janë publike për të gjithë, mua më rezulton që kostoja e këtyre shkon sa 1/10 e një desktopi normal dhe unë këtë për të qenë dhe për t'i dhënë hapësirë po e pesëfishoj, pra nga 1/10 po e bëj 1/2, me këtë arsyetim. Nëse janë dakord anëtarët mirë, në qoftë se s'janë, të kaloj tek propozimi edhe për dy zyrat e tjerë që kisha në diskutimin tim.

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Atëherë, me sa kuptoj unë, zonja Kadi kishte disa propozime alternative lidhur me shpenzimet që duhet të bëhen sipas zërave. Mundet që teknika IT-së të na tregojë nëse propozimet që bën zonja Kadi janë alternativa më e mirë se ajo që janë sot dhe të na tregojnë edhe atë masën e atyre shpenzimeve. Sepse kam përshtypjen që ato ndikojnë në zërat e tjerë pastaj. Nëse pranojmë që alternativa më e mirë është dika tjetër, mund të reflektojnë edhe tek zërat e tjerë dhe do duhet të modifikohet i gjithë propozimi.

**Brunilda Kadi:** Meqenëse po presim derisa të vijë IT-ja, unë po kaloj tek propozimi tjetër për gjeneratorin? Okej!

**Marçela Shehu:** Jo! Kam një pyetje lidhur me gjeneratorin.

Ju thatë në fjalën tuaj që gjeneratori është planifikuar që të përmbushë nevojat e të gjithë godinës, ku do të ushtrojnë funksionin tre institucione. A mundet të realizohet një marrëveshje, që shpenzimet për këtë zë të realizohen nga të tre institucionet?

**Luljeta Laze:** Atëherë, që edhe një herë t'i kthehem.

Përcaktimi i gjeneratorit me këtë fuqi dhe tregues teknikë është i tillë sepse është nga projekti që ka godina.

Është e pamundur që të ndaheshe për secilën, këtë e shpjegoja.

Ndërsa për sa i përket faktit të ndarjes së shpenzimeve, në fakt, ndoshta, nuk jam shumë e sigurt me ligjin e prokurimeve, ka një lloj vështirësie, por ndoshta edhe mund të bëhet. Nuk e jap dot të qartë tani. Bërja e disa gjeneratorëve Bruna, doja të thoja, e para njëherë që teknikisht është e pamundur që të bësh gjenerator vetëm për sallën, për mënyrën sesi edhe ajo është e ndërtuar sepse që në projekt programohen fuqitë e rrjetit, ku do vendosen, e me radhë. Se s'dua të bëj gabime. Me sa kam komunikuar gjatë gjithë kësaj kohe me specialistët është e pamundur që siç të vjen për një argument, le të themi,

pozitiv për uljen e shpenzimeve, siç të vjen tani që të bëjmë një gjenerator vetëm për sallën, nuk ndodh çdo lloj propozimi që ti ke kur ajo lidhet me një godinë që tashmë është e përfunduar, një dhe e dyta, nuk më duket shumë e arsyeshme vetëm për sallën. Në fund të fundit, në qoftë se kjo është siguri e burimit të dytë të energjisë, nuk ka pse... nuk është vetëm salla. Aty do mbeten pa punuar 100 veta. Kështu që gjeneratori është në këtë kuptim. Dhe.. Lidhet pastaj gjeneratori, si do ndash, vetëm një për sallën, po për sa i përket serverit? Do blejmë një gjenerator tjetër? Blerja e dy gjeneratorëve, të jesh e sigurt që edhe sikur të jenë me fuqi më të ulëta, kushton shumë më shtrenjtë sesa një.

**Brunilda Kadi:** Në kuadër të pyetjes që bëri Marçela, keni informacion, dy institucionet e tjera e kanë detajuar buxhetin?

*(Zonja Luli përgjigjet pa ndezur mikrofonin.)*

Se mbas e kanë parashikuar ata këtë gjë.

*(Zonja Shehu flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Marçela Shehu:** Unë do propozoj që të shtyhet.

*(Pjesëtarë të stafit flasin pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Pse e kemi më shumë se shkolla ne?

*(Pjesëtarë të stafit flasin pa ndezur mikrofonin. Ndërkohë futen në sallën e mbledhjes dy IT të institucionit.)*

**Brunilda Kadi:** Okej, okej.

Bëjmë këtë pyetje që kërkon informacion teknologjik, pastaj...

Përshëndetje!

Atëherë, sipas detajimit të buxhetit, sipas propozuesve është marrë mendimi nga IT-ja për një sërë produktesh që janë këtu dhe bëhet fjalë për kompjutera desktop (30 copë). Nga informacioni që kam unë, di që ekziston një zgjidhje teknologjike e tillë, që ti ke 30 desktop ose 30 mijë desktop dhe 1 njësi qendrore që shërben si truri i të gjithave. Dhe unë di që kjo teknologji është shumë e përhapur, të paktën në vendet e tjera dhe sidomos në për njësi, subjekte private apo shtetërore, ku ka shumë përdorues. Di që kostoja është shumë herë më e vogël të blesh 30 desktopa dhe 1 njësi qendrore apo të blesh 30 desktopa bashkë me 30 njësi qendrore. Përveç arsytimit të “ekologjike” e me

radhë.

**Klodian Kreçi:** Për sa i përket desktopave, normalisht do blihen edhe pajisje që janë PC, që janë shumë të vegjël, që ato të lidhen nëpërmjet rrjetit të brendshëm dhe gjitha të tjerat. Sepse realisht nuk ka një monitor të vetëm që t'i përmbajë edhe pjesën e USB-ve dhe pjesën..

Një kosto të përafërt. Nuk është se kemi bërë një studim të mirëfilltë tek kjo pjesa, por që të bëhet kjo teknologjia, i bie që ne të bëjmë një blerje tjetër përsëri, duke qenë se neve kemi bërë një blerje të pjesës më të madhe të pajisjeve, që janë 44 copë që janë blerë vjet, që janë blerë për vitin 2019.

Janë blerë për vitin 2019 44 pajisje PC (43 plus 1 që është...).

Dhe kështu që, eliminoam atë pjesën. Duke qenë se na ngeli një pjesë më e vogël pajisjesh të tjera, që i bie të jenë vetëm 30 copë. Në qoftë se neve do bënim këtë blerjen e re, i bie që e gjithë pjesa tjetër e kompjuterëve që neve kemi në përdorim, që janë diku tek 26 që do mbajmë, që i bie nga viti 2015 dhe mbrapa, këto pajisjet që kemi, plus kompjuterat e rinj që neve blemë, atëherë do dilnin jashtë përdorimit të gjitha pajisjet e tjera që neve kemi aktualisht.

**Brunilda Kadi:** Më fal! Nuk mund të punojnë për shembull këta të 30 me një njësi, këta të punojnë siç punojnë?

**Klodian Kreçi:** Ajo është një teknologji tjetër.

Do të thotë që, neve do blejmë një server të përgjithshëm. Përveç këtij serveri, neve do blejmë pajisje të tjera që janë pajisje si desktopi, siç është desktopi, njësi qendrore që neve kemi, janë njësi qendrore shumë të vogla, që vendosen ngjitur me secilin person. Sepse ajo kushton.

*(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brunilda Kadi:** Po flas për teknologji tjetër. Pra 30 desktopa ose 3000, me 30 që do blejmë ne dhe 1 njësi qendrore.

*(Zonja Kadi e ndez mikrofonin.)*

Atëherë, në qoftë se ne marrim këto 30 kompjuterat e rinj me 1 njësi qendrore, nga ana teknologjike çfarë problemi ka me ato 26 kompjuterat e tjerë, që do punojnë secili

me njësinë e vet? Pse duhet të kenë lidhje organike me njeri-tjetrin ata? Ku prishet puna?

**Klodian Kreçi:** Problemi do qëllojë, me sa kam informacion, nuk është se kemi bërë një studim të mirëfilltë tek kjo pjesa sepse ky do quhet një server qendror për të gjithë administratën dhe normalisht do ketë një kosto më të lartë sesa një server i thjesht që neve kemi bërë blerje për sa i përket vitit 2019, në të cilin kemi bërë dy servera të rinj. Kështu që, do shtojmë edhe një pajisje tjetër me vlerë diku të përafërt me vlerën e këtyre 30 pajisjeve (shkon si kosto). Kështu që, kosto është e përafërt aty-aty me çmimin që janë për këto 30 njësi.

**Brunilda Kadi:** Faleminderit!

Atëherë, duke qenë se eksperti i fushës deklaroi që kostoja shkon aty-aty, unë tërhiqem nga ky propozim sepse mendoj që ai e di më mirë sesa unë.

Unë do vazhdoj me propozimin e dytë, për gjeneratorin. Edhe pasi dëgjova përfaqësuesin e njësisë së buxhetit, përsëri kam propozimin që ligjërisht ekziston mundësia që ne këtë produkt ta miratojmë më vonë për të harxhuar këtë fond dhe për momentin të mos e miratojmë. Të presim edhe dy institucionet e tjera, të presim këtë mundësi, që pyeti edhe Marçela, për marrëveshje, që ky shpenzim të ndahet midis tre institucioneve dhe ta lemë zero me – tani nuk e di, të na e sqarojë vetë njësi, sesi ekziston ligjërisht mundësia që ne ta alokojmë më vonë, ta miratojmë më vonë këtë.

*(Zoti Haxhiu flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Xhevdet Haxhiu:** Ta çojmë tek fondi që kemi të pandarë.

**Brunilda Kadi:** Okej! Sepse është një shifër e konsiderueshme.

Kurde për detektorin, në qoftë se ju deklaroni, “deklaroni”, – na falni për termin, se unë nuk e di, por nisur nga ajo që tha Erjoni, -thoni që godina për momentin nuk është e ndarë dhe nuk do kishte kuptim detektorin në qoftë se ne hyjmë nga një derë, të tjerët hyjnë nga dyer të tjera dhe aksesojnë, atëherë s’ka kuptim po s’është bërë kjo ndarja. Ju thoni që është bërë ndarja. Atëherë, tërhiqem.

Unë kam propozim për t’u hequr gjeneratorin.

**Naureda Llagami:** Dritan!

**Dritan Hallunaj:** Po! Faleminderit!

Atëherë, duke dëgjuar objeksionet që kanë anëtarët në lidhje me sa u relatua, desha të bëj me dije se për sa i përket pjesës së kompjuterëve, u sqarua dhe nuk po rrimë që ta përsërisim, se është thënë dhe është stër thënë disa herë.

Ndërsa, për sa i përket pjesës së gjeneratorit, duke patur parasysh, domethënë kur kam qenë drejtues i Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe kemi marrë përsipër menaxhimin e ndërtesës në atë kohë, është marrë edhe pjesa e gjeneratorit, që është në pronësi të Gjykatës së Krimeve të Rënda. Është një gjenerator për të gjithë ndërtesën, pavarësisht se në atë institucion janë disa institucione të tjera, në atë ndërtesë janë shumë institucione të tjera (ke shkallën e parë, është gjykata e apelit, është prokuroria e shkallës së parë, prokuroria, ka qenë Zyra e Administrimit të Buxhetit dhe një kategori tjetër). Kujtoj, me sa kujtoj (ndërkohë që isha në mbledhje, i kërkova një kopje) është bërë një Memorandum bashkëpunimi midis institucioneve dhe midis këtyre institucioneve (e kam unë memorandumun, tani ma sollën me uocap (*whatsapp*)) është pjesa e ndarjes së shpenzimeve dhe shpenzimet janë ndarë sipas metrave katror, me sa kujtoj unë, se nuk e lexova të tërin, shpenzimet janë ndarë me metër katror dhe në këtë mënyrë zgjidhet gjithë ajo pjesa e shpenzimeve që mos të paguajmë ne për një institucion tjetër, -mendoj unë. Pra thjesht është shumë e qartë. Nuk ka arsye pse të...

Ndërsa për pjesën tjetër për metal-detektorin, ne po kërkojmë të ndërtojmë një institucion me standarde, që të krijojmë diçka ndryshe, pavarësisht se sa... Metal-detektorë kanë filluar të vënë spitalet private, e jo mos të vëmë në një institucion të tillë të kësaj kategorie dhe për mua është biseda më banale nëse metal-detektori mos të vendoset, se po kursejmë ne tek pjesa e metal-detektorit.

Unë desha të komplimentoj Zyrën e Administrimit të Buxhetit për të gjithë detajimin dhe për të gjithë këto dhe unë jam pro këtij detajimi që ka bërë Zyra e Administrimit të Buxhetit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Po, zoti Muharremaj!

**Erjon Muharremaj:** Kisha edhe një pyetje tjetër ju lutem, në lidhje me zërin me numër rendor 11, në Pasqyrën nr. 2. Shifra prej 10.300.000 lekësh për projektin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës: - A është e vërtetë që ka një projekt të depozituar



për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës?

**Luljeta Laze:** E sigurt që jo. Shumë e sigurt që jo.

Jam shumë e sigurt që një projekt nuk ka.

Drafte të ndryshme se si do duket ajo pjesa, është tjetër gjë... Nga idetë që jepen se si do duket kur ne japim lejen... *(ka shkëputje herë pas here regjistrimi)*.

Atëherë, na i jep ne një projekt sepse unë kam qenë në komunikim të vazhdueshëm me Joanën për këtë gjë dhe projekt nuk është bërë asnjëherë.

E keni fjalën për idetë e projektimit, se si do duket ajo zonë kur të ngrihen këto institucione. Për këtë jam e sigurt.

**Brunilda Kadi:** Meqenëse janë IT-të, se e diskutuam dhe diçka u shpjegua.

**Luljeta Laze:** Më fal! Më fal që ta mbaroj mendimin.

Ose, nëse vërtet ekziston një projekt dhe unë nuk e kam disponuar asnjëherë, të na vihet në dispozicion. Është e thjeshtë fare. Hiqen ato...

**Brunilda Kadi:** Një pyetje teknologjike.

*(Kërkon fjalën përpara zoti Muharremaj.)*

**Erjon Muharremaj:** Atëherë, derisa të sqarohet nëse ka apo jo projekt të depozituar, propozoj që edhe kjo shifër të hiqet nga kjo.

*(Anëtarët flasin të gjithë njëherësh pa ndezur mikrofonat.)*

**Brikena Ukperaj:** Një sekondë. Një sekondë. Meqenëse ZABGJ-ja ka administruar të gjithë buxhetin e gjykatave më përpara dhe vazhdon edhe sot. Për shkak të kompetencave edhe më parë ajo ka qenë në dijeni të faktit që ka patur apo s'ka patur projekt. Kështu që unë mendoj që përgjigjja që jep zonja Luli është zyrtare.

**Naureda Llagami:** Atëherë, zonja Kadi, lidhur me...

**Brunilda Kadi:** Një pyetje teknologjike për IT-të.

**Naureda Llagami:** Meqë është IT-ja.

**Brunilda Kadi:** Po!

Për sistemin e qarkullimit të dokumentave, produkti nr. 19, na u shpjegua pak a shumë edhe tek relacioni çfarë do jetë. Ky softi që mendohet të blihet dhe të instalohet, a do jetë i aftë që të bëjë një veprim të tillë, për shembull: I gjithë dokumentacioni që hyn

në KLGJ (në Këshillin e Lartë Gjyqësor), të depozitohet aty dhe pastaj të ketë nivele akses, për shembull për anëtarët të ketë akses, të bëjnë koment ose administrata thjesht të ketë akses ta lexojë, e me radhë. Ky softi e bën të mundur këtë veprim?

**Enida Muceku:** Atëherë, sistemi i qarkullimit të dokumentave funksionon me një softuer (*software*) që është kloud sorc (*closed source*) pra me kod burimi të mbyllur dhe ky sistem është më i avancuar në krahasim me sistemet e tjera që përdoren në pushtetin gjyqësor, siç është sistemi i menaxhimit të çështjeve, që është program me kod të hapur. Softueri (*software*) me kloud sorc (*closed source*) është softuer (*software*) i projektuar qëllimisht për qarkullim dokumentash që kanë materiale konfidenciale dhe ky soft funksionon që mund të caktohen privilegje në rast se informacionet që do t'i jepen të drejtë të përdoren nga anëtarët, nuk mund të shikohen nga një sektor tjetër në institucion. Pra mund të bëhen ndërhyrje për kufizim akses.

Po! Po!

*(Zoti Muharremaj bën një pyetje pa ndezur mikrofonin, sa i përket qirasë së softit. Ndërkohë disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

**Enida Muceku:** Atëherë, në lidhje me këtë profesor.

*(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

Në lidhje me pyetjen tuaj, nga informacionet që unë kam dhe kërkimet që kam bërë në internet ky lloj softueri (*software*) nuk funksionin me metodikën lizing (*leasing*), pra me qira, është softuer (*software*) që funksionon me licenca të dedikuara dhe nuk aplikohet kjo metodë me dhënie me qira, të paktën në Shqipëri dhe në botë.

**Naureda Llagami:** Atëherë Bruna edhe një herë, pra kush ishin, se ngaqë bëmë shumë diskutime, u sqaruam dhe të jemi konkret tek propozimi jot.

**Brunilda Kadi:** Unë i qëndroj, edhe mbasi dëgjova Dritanin, unë i qëndroj propozimit tim që shpenzimi për gjeneratorin të lihet në një moment tjetër mbasi të ezaurohen këto hapat, qoftë edhe ajo që propozoi Tani, domethënë një memorandum për ndarje shpenzimesh.

**Naureda Llagami:** Jo po, se s'kanë shumë lidhje bashkë ato. Ajo është pjesë e hapit të dytë.

**Brunilda Kadi:** Okej. Po në momentin e dytë, në një moment të dytë mund ta miratojmë. Unë them që të hiqet kjo shpenzimi i gjeneratorit. Ky është propozimi im.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në votim lidhur me propozimin e bërë nga zonja Kadi.

Po zoti Toska, se po e hedhim në votim, prandaj!

**Ilir Toska:** Sa i përket gjeneratorit, do të duhet të konsiderojmë që gjeneratori do të përdoret nga të gjithë institucionet e tjera, që i bie që duhet të kontribuojnë të gjithë qoftë në blerje, qoftë në mirëmbajtje apo edhe në përdorimin e tij në të ardhmen. Mbase do të ishte mirë që të kishte një marrëveshje të përbashkët e gjithë institucioneve, që të kishim një mirëkuptim të tillë sepse ndryshe ne nesër do fillojmë konfliktet me institucionet e tjera që ne jemi pronarë të gjeneratorit, ju s' duhet të merrni, ju s' duhet, duhet të paguani për mirëmbajtjen dhe do kemi gjithmonë konflikte të kësaj natyre mbase. Mundet që këtë fondin ta alokojmë në momentin që të rakordojmë me të gjitha institucionet.

**Naureda Llagami:** Atëherë thjesht për t'ju sqaruar pak mënyrën e programimit të fondeve. Programimi i fondeve s' do të thotë që ne e programuam dhe ne sot e shpenzuam. Pra ky është një lloj programimi që ne bëjmë që i paraprijmë vetes lidhur me nevojat që kemi. Unë jam në negociata shumë të ngushta lidhur me qeverisjen për sa i përket mënyrës së menaxhimit të godinës, ku është e pritshme, nëpërmjet një VKM-je do na kalohet edhe një shoqëri e cila do na i zgjidhi të gjitha këto problemet që ne diskutuam tashmë lidhur me gjeneratorin. Problemi është që ne mos të ndodhemi në individualitetin që... sepse rregullat e buxhetit, të paktën me sa kam kuptuar unë deri tani, nuk të lejojnë ty që në minutë të fundit të vendosësh ti atë fondin dhe ta kalosh tek gjeneratori, pra duhet ta kesh diçka të parashikuar. Nuk mund të ndryshojmë gjërat në minutën e fundit. Kështu që neve propozuam, të paktën nga drejtoria përkatëse, propozoi që ne ta kemi si fond. Ndërkohë që deri në fund të marsit mendohet që kjo VKM-ja, bashkë me këtë shoqërinë do të na mundësojë mirëmbajtjen e godinës. Në momentin që kjo kalon, VKM-ja, bashkë me shoqërinë, pa diskutim që ne do futemi në mbledhje dhe kostot e një gjeneratori që ndoshta do na i bëjë shoqëria, ne do t'i kalojmë tek fondi jonë i përbashkët.

Thjesht kjo është një mënyrë programimi që nesër-pasnesër mos të bllokohemi në momentin që ne do shkojmë atje, në eventualitetet që do kemi në zbatimin e një godine dhe mirëmbajtje të re.

Megjithatë prapë kjo është vendimmarrja e juaj.

Kështu që unë kaloj në votim propozimin e bërë nga zonja Kadi dhe...

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Edhe unë kundër, me idenë që ai fond le të jetë dhe pastaj të tëra këto problemet e ngritura nga Bruna, të shihen në fazat e ekzekutimit të tij.

**Marçela Shehu:** Pro.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Medi Bici:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Kundër.

Atëherë kalojmë projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Maksim Qoku:** Pro.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Pro.

**Alban Toro:** Pro.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Pro, me rezervën për gjeneratorin.

**Erjon Muharremaj:** Pro, me rezervën për gjeneratorin dhe projektin e godinës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

*(Vota e zonjës Llagami nuk dëgjohet.)*

**Naureda Llagami:** Atëherë Këshilli vendosi: “Miratimin e vendimit për detajimin e buxhetit dhe shpenzimet kapitale për sistemin gjyqësor në vitin 2020”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 20.02.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për nxjerrjen nga përdorimi të aseteve në pronësi të disa gjykatave” i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:06 dhe mbaroi në orën 14:27.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 5. Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.**
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 7. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 9. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 10. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 11. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 12. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 13. Gregor Borgowski, EURALIUS.**
- 14. Anisa Kuqi, EURALIUS.**
- 15. Valbona Bala, USAID.**
- 16. Erion Fejzulla, USAID.**

## **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për nxjerrjen nga përdorimi të aseteve në pronësi të disa gjykatave” i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës, e cila ka të bëjë me miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aseteve në disa gjykata.

Për më shumë detaje i jap fjalën sërish zonjës Luljeta Laze.

*Luljeta Laze:* Atëherë, për të qenë konciz duam t’ju themi që të gjitha asetet që gjykatat kanë, si njësi shpenzuese të veçanta, pasi ndjekin një procedurë të mirëpërcaktuar nga aktet, kur ato duan t’i nxjerrin nga përdorimi për arsye të ndryshme, qoftë për faktin që mund të kenë plotësuar, nuk janë më në gjendje që t’i përgjigjen nevojave që gjykatat kanë funksionet ato asete kanë kryer deri në atë moment, janë të detyruar që gjykatat kanë dhe funksionin që ato asete kanë kryer deri në atë moment, janë të detyruar që të ndjekin një procedurë të qartë se si duhet të veprojnë për nxjerrjen e tyre nga përdorimi; dhe pasi plotësojnë të gjithë dokumentacionin që e bën gjithë njësia shpenzuese, ato i sjellin dhe kalojnë në një filtër të dytë në strukturën tonë, e cila shikon ndjekjen e procedurës dhe, në të gjitha rastet kur procedura nuk është ndjekur ashtu si duhet, rikthehen për plotësim. Pra jemi në kushtet kur 3 nga gjykatat, 5 gjykata gjithsej kanë sjellë nevojën e tyre për nxjerrjen nga përdorimi, 3 prej tyre janë automjete dhe 2 janë grup-asetesh të tjera të cilat kanë bërë një procedurë të plotë dhe të saktë të verifikuar për nxjerrjen e tyre nga përdorimi, në përputhje me aktet ligjore.

Është për t’u nxjerrë nga përdorim automjeti tip Volkswagen Bora, prodhim i vitit 2000 për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë. Automjeti Volkswagen Bora, prodhim i vitit 2000 për Gjykatën e Apelit Vlorë si dhe një automjet tip Mercedes, prodhim i vitit 1997 në Gjykatën e Rrethit Pogradec. Këto janë 3 automjetet që duhet të nxirren.

Ndërsa grup-asetesh janë: një grup-asetesh pajisje elektronike nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje e cila ka sjellë në mënyrë të detajuar gjithë listën e pajisjeve si



dhe një grup-asetesh që janë pajisje zyre dhe të sallave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

**Naureda Llagami:** Atëherë kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Kalojmë në votim sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi: Miratimin e projektvendimit për nxjerrjen nga përdorimi të aseteve në pronësi në disa gjykata, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik të Administrimit dhe Buxhetit.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 20.02.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:06 dhe mbaroi në orën 14:27.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 12. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 13. Valbona Bala, USAID.*
- 14. Erion Fejzulla, USAID.*

**RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me shqyrtimin projektvendimit lidhur me ndryshimin e vendimit nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshilli të Lartë Gjyqësor.

Për më shumë detaje për relatimin e projekt-aktit, fjalën ia jap zonjës Brunilda Kadi.

**Brunilda Kadi:** Po! Faleminderit!

Atëherë, shkurtimisht. Sipas vendimit 112, datë 09.07.2019, nga Këshill janë caktuar, për periudhën korrik 2019 - 30 qershor 2020, magjistratët gjyqtarë udhëheqës, për këtë vit akademik.

Duke qenë se me vendimin nr. 68, 06.02.2020, Këshilli vendosi komandimin e gjyqtarës Marinela Osmani, në pozicionin e Këshilltarit Ligjor pranë Këshillit, komandim i cili do të jetë për periudhën 2-vjeçare duke filluar nga data 10.02.2020 dhe kjo gjyqtare e komanduar ka qenë udhëheqës i kandidatit për magjistrat, profili gjyqtar, znj. Sonila Hoxha, atëherë del e nevojshme për periudhën që ka ngelur nga koha, për periudhën nëntor - shkurt 2020 të ndryshojë, të zëvendësohet magjistrati udhëheqës me një magjistrat tjetër po nga lista e miratuar nga Këshilli dhe ajo që propozohet është që për këtë periudhë, 4-mujorin e dytë nëntor - shkurt 2020, për kandidaten për magjistrat, profili gjyqtar, znj. Sonila Hoxha, të zëvendësohet gjyqtari udhëheqës znj. Marinela Osmani me magjistratin gjyqtar udhëheqës znj. Teuta Hoxha.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Kadi!

Atëherë kemi ndonjë diskutim?

Kalojmë në votim të projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi: Të zëvendësojë gjyqtarin udhëheqës, znj. Marinela Osmani, e caktuar për kandidatin për magjistrat, profili gjyqtar, znj. Sonila Hoxha, për periudhën e mbetur nga katërmujori i dytë, nëntor – shkurt 2020, me magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. Teuta Hoxha.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 20.02.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si më poshtë:

1. “Për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”;
2. “Për caktimin e gjyqtares në skemën e delegimit, znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:06 dhe mbaroi në orën 14:27.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>11. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 7. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 8. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 9. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 11. Gregor Borgowski, EURALIUS.**
- 12. Anisa Kuqi, EURALIUS.**
- 13. Valbona Bala, USAID.**
- 14. Erion Fejzulla, USAID.**

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si më poshtë:

1. “Për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”;

2. “Për caktimin e gjyqtares në skemën e delegimit, znj. {...}, në Gjykatën e Apelit Korçë”.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtares në skemën e delegimit, znj. {...} në Gjykatën e Apelit...

*(Një anëtar flet pa ndezur mikrofonin.)*

Komandimin. Po!

**Marçela Shehu:** Po! Faleminderit Kryetare!

Më datë 05.02.2020, gjyqtarja {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka paraqitur një deklaratë para Këshillit, me të cilën ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit në çdo gjykatë që do të caktohej.

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në vitin ‘94. Pas studimeve ka punuar në sistemin e drejtësisë dhe me vendimin nr. 167 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë më datën 16.12.2004 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Më pas, me vendimin nr. 260 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë më datën 01.04.2010 është transferuar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku ushtron detyrën dhe aktualisht.

Neni 45 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcakton rregullimin ligjor lidhur me organizimin dhe funksionimin e skemës së delegimit, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga magjistratët për t’u pranuar në këtë skemë si dhe detyrimin e Këshillit për të përcaktuar rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magjistratëve si dhe kohën e shërbimit për skemën e delegimit, duke parashikuar ndër të tjera se: “Magjistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t’u komanduar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill. Magjistrati shërben në skemën e delegimit jo më shumë se 5 vjet. Magjistrati që kandidon për pozicione në skemën e delegimit, nënshkruan një deklaratë për dhënien e pëlqimit për t’u caktuar në çdo gjykatë ose prokurori.”



Në zbatim të nenit 45 të ligjit 96/2016, pra të ligjit të sipërcituar, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 22, datë 07.02.2019, ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”. Konkretisht, nenin 4 të kësaj rregulloreje parashikon kriteret e kandidimit në skemën e delegimit. Sipas këtij neni, në skemën e delegimit kandidon çdo gjyqtar që plotëson këto kriteret: Të ketë dhënë pëlqimin për t’u komanduar në skemën e delegimit; Të ketë jo më pak se 1 vit përvojë në funksion; Të mos jetë nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit; Të mos ushtrojë funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit; Të mos jetë i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e saj; Të mos jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim.

Bazuar në rrethanat e parashtruara më sipër, në lidhje me parashikimet ligjore të nenit 45 të ligjit 96/2016 si dhe në lidhje me parashikimet e vendimit 22, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni vlerëson se në rastin konkret, jemi në kushtet e pranimit të përfshirjes së gjyqtares {...} në skemën e delegimit, pra jemi në kushtet e komandimit të saj në këtë skemë pasi: gjyqtarja ka dhënë pëlqimin për t’u komanduar në skemën e delegimit; ka më shumë se 1 vit përvojë në funksion; nuk ndodhet nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit; nuk ushtron funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit; është e caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi nuk cenon funksionalitetin e saj, pasi aktualisht rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës ushtrojnë funksionin 13 gjyqtarë me një ngarkesë mesatare prej 100 çështje në shqyrtim; nuk rezulton të jetë duke ushtruar funksionin e saj si gjyqtare në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim.

Bazuar sa më sipër, Komisioni vlerëson se gjyqtarja {...}, plotëson kriteret për t’u komanduar dhe përfshirë në skemën e delegimit.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.

Komandimin e gjyqtares {...} në skemën e delegimit, të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një afat 2-vjeçar.

Përfundimin e gjyqtares znj. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Efektet juridike të vendimit fillojnë nga dita e njoftimit.

Një kopje e vendimit t'i njoftohet gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë nëse kemi ndonjë diskutim.

**Brikena Ukperaj:** Doja të pyesja, pse është zgjedhur afati 2-vjeçar, thjesht pse e keni vendosur afatin 2-vjeçar apo thjesht është marrë një afat edhe...?

**Marcela Shehu:** Afati për t'u komanduar në skemën e delegimit sipas rregullores dhe sipas ligjit është deri në 5 vjet, minimumi është 6 muaj, duke pasur parasysh që në eventualitetin që procesi i rivlerësimit mund të shkaktojë pasoja negative në gjykatën ku ushtron detyrën zonja {...}, kemi parashikuar një afat të mesëm prej 2 vjetësh. Gjithsesi nëse Këshilli e vlerëson ndryshe, ky është një propozim, nëse Këshilli e vlerëson ndryshe mund të propozoni një afat tjetër më të shkurtër por jo më të shkurtër se 6 muaj dhe jo më të gjatë se 5 vjet.

**Brikena Ukperaj:** Mendoja se duhej të ishte shprehja e vullnetit të gjyqtares se sa... sepse varet dhe nga vullneti i gjyqtarit.

**Marcela Shehu:** Jo, jo! Zonja {...} nuk ka shprehur vullnet në lidhje me kohën, jo.

**Nuareda Llagami:** Atëherë, kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga komisioni?

**Brikena Ukperaj:** Unë mendoj që paraprakisht, e çmoj të nevojshme që gjyqtarja duhet të japë pëlqim ose duhet të pyetet për afatin se sa duhet të komandohet në skemë delegimi. Sepse duke qenë një skemë e vullnetshme ajo patjetër që duhet të kishte dhënë

pëlqim për afatin për të cilin ajo kërkon të komandohet në skenë delegimi. Se në qoftë se gjyqtarja thotë që dua 3 vjet për shembull, ne nuk kemi rregulla se sa.

**Nuareda Llagami:** Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Nuk mendoj se duhet të pyesim gjyqtaren se sa do të rrish në skemën e delegimit. Gjyqtarja është e qartë që në skemë delegimi rrihet deri në 5 vjet. Këshilli ka të gjithë deskricionin që të vlerësojë rast pas rasti se sa duhet të shërbejë një gjyqtar në skemën e delegimit. Nuk është çështje pëlqimi më mbani 1 vit apo më mbani 6 muaj.

Nëse gjyqtarja do ta kishte thënë këtë, duhet ta konsideronim. Gjyqtarja është shprehur “më përfshini në skemë delegimi” dhe fakti që konsideron që më përfshini në skemë delegimi, do të thotë që pranon edhe afatin maksimal të përfshirjes. Çdo më thënë?!

**Nuareda Llagami:** Kalojmë në votim.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

*(Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet.)*

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi: Për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}.

Pranimin e kërkesës së gjyqtares {...}. Komandimin e gjyqtares {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për një afat 2-vjeçar.

Përfshirjen e gjyqtares {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka lidhje me këtë vendimmarrje, relator i të cilës do të jetë znj. Shehu, e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarës në skemë delegimi në Gjykatën e Apelit Korçë.

**Marçela Shehu:** Po! Faleminderit Kryetare!

Gjykata e Apelit Korçë ka paraqitur rreth 150 kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve të veçanta. Numri i lartë i kërkesave të paraqitura nga kjo gjykatë lidhet me faktin se tashmë kjo gjykatë rezulton të jetë jashtë funksionit, pasi detyrën në këtë gjykatë e ushtrojnë vetëm dy gjyqtarë.

Në këto kushte, me qëllim kthimin në funksionalitet të kësaj gjykate, pas ngritjes tashmë të skemës së delegimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe pranimin për komandim në këtë skemë të një gjyqtareje, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, bazuar në nevojat e mëdha të paraqitura nga Gjykata e Apelit Korçë, vlerëson t’i propozojë Këshillit të Lartë Gjyqësor, caktimin e gjyqtarës {...} për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë, si zgjidhja më e mirë e mundshme që mund të ndërmerret në situatën konkrete. Neni 45 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera në pikën 4 të tij, parashikohet se Këshilli cakton magistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate ose prokurorie në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magistrati përmbush kërkesat.

Rezulton se gjyqtarja {...} ushtron funksionin si gjyqtare e shkallës së parë por plotëson kriteret ligjore për të gjykuar në një gjykatë të shkallës së dytë, në rastin konkret

në një gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm, pasi rezulton të ketë ushtruar detyrën e gjyqtarit në shkallë të parë prej më shumë se 15 vjetësh, pra përmbush kërkesat e ligjit për t'u caktuar në këtë pozicion.

Sjellim në vëmendje faktin se, gjyqtarja {...} është e vetmja gjyqtare e përfshirë në skemën e delegimit, ndaj në këtë rast nuk ka vend për procedurat e shortit, sipas parashikimit të vendimit nr. 22, datë 07.02.2019 “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit”.

Në këto kushte, Komisioni i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën deri më 15.09.2020. Gjyqtarja e skemës znj. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Korçë për periudhën deri më datë 15.04.2020, duke pasur parasysh që ajo do të vijojë të gjykojë edhe çështjet e papërfunduara ende në gjykatën nga e cila vjen, pra në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Efektet juridike të këtij vendimit fillojnë në datën e njoftimit.

Një kopje e vendimit t'i dërgohet gjyqtares dhe Gjykatës së Apelit Korçë.

Faleminderit!

**Nuareda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, keni ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

**Brikena Ukperaj:** Jam dakord me projekt-aktin, por për të qenë në koherencë midis dy pasojave juridike që propozohen të fillojnë nga miratimi i të dy akteve, në qoftë se themi që komandimi në skemën e delegimit, efektet i ka në momentin e njoftimit të gjyqtares, do të thotë që ky vendimi i parë nuk na ka prodhuar akoma efekte që të kalojmë tek vendimi i dytë, për ta komanduar në Korçë sepse e miratuam me efekte nga momenti i njoftimit të vendimit.

Sot, që të kalojmë tek miratimi i dytë, vendimi i parë nuk na ka ende fuqi juridike, pra nuk prodhon pasoja juridike. Ndoshta duhet t'i njoftohet pastaj të kalojmë në vendimmarrjen tjetër. Në qoftë se do ta kishim shkruar që ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet.

**Alban Toro:** Është akt individual.

**Brikena Ukperaj:** Po pra, duke qenë se është akt individual, efektet e vendimit nga momenti i njoftimit të vendimit dhe ne nuk ia kemi njoftuar vendimin ende.

**Brunilda Kadi:** Të themi që ky vendim hyn në fuqi mbasi të hyjë ai tjetri.

**Brikena Ukperaj:** Në rregull. Okej!

**Brunilda Kadi:** Mendoj që mund të zgjidhet duke parashikuar tek vendimi i dytë, që ky vendimi i dytë hyn në fuqi mbasi hyn në fuqi ai i pari dhe besoj se zgjidhet. Tani formulimin.

*(Zonja Ukperaj flet pa ndezur mikrofonin.)*

**Brikena Ukperaj:** Në të njëjtin moment?

**Brunilda Kadi:** Jo, jo! Pra hyn në fuqi mbasi...

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

**Naureda Llagami:** E hedhim në votim.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Atëherë e hedhim në votim vendimin sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

*(Vota e zotit Bici nuk dëgjohet.)*

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e projektvendimit për caktimin e gjyqtarës në skemën e delegimit të znj. {...} në Gjykatën e Apelit Korçë, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 20.02.2020)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndryshimin e pjesëshëm dhe korigjimin e gabimit në shkrim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 21.01.2020, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:06 dhe mbaroi në orën 14:27.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)



**10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

**11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
2. **Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
3. **Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
4. **Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
5. **Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
6. **Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
7. **Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
8. **Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
9. **Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
10. **Enida Muceku, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve. (dy pikat e fundit)**
11. **Helios Reveli, EURALIUS.**
12. **Rezart Alija, EURALIUS.**
13. **Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
14. **Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
15. **Gregor Borgowski, EURALIUS.**
16. **Anisa Kuqi, EURALIUS.**
17. **Valbona Bala, USAID.**
18. **Erion Fejzulla, USAID.**

## **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndryshimin e pjesshëm dhe korrigjimin e gabimit në shkrim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 21.01.2020, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me ndryshimin e pjesshëm dhe korrigjimin e gabimit në shkrim të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 21.01.2020 “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”. Ky projekt-akt do të relatohet nga z.Illir Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim për ndryshimin e pjesshëm dhe korrigjimin e një gabimi në shkrim të vendimit nr. 30, datë 21.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”.

Ky projektvendim është marrë shkas nga rrethanat e rastit. Për këtë është përgatitur edhe një relacion shpjegues sipas së cilit një kërkesë... (*zoti Toska e rifillon edhe një herë shqyrtimin e kësaj çështjeje për shkak të mosregjistrimit audio.*)

Atëherë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim për ndryshimin e pjesshëm dhe korrigjimin e gabimit në shkrim të vendimit nr. 30, datë 21.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”.

Për këtë projektvendim është përgatitur edhe një relacion shpjegues.

Në relacionin shpjegues jepen arsyet se pse komisioni ka përgatitur këtë projektvendim.

Kështu mbi disa kërkesa të Kryetarit Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, të ardhura deri me datë 20 janar 2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shqyrtuar ndër të tjera edhe kërkesën nr. 44 prot., datë 15.01.2020 që

identifikonte si nevojë të kësaj gjykate, një çështje gjyqësore penale, ku akuza ndaj të pandehurit është “mashttrim i kryer në bashkëpunim”, ndërsa kërkohej caktimi i 1 gjyqtari. Çështja mbante nr.28. Për të gjitha kërkesat e ardhura deri më datë 20 janar 2020 nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, përfshirë edhe çështjen si më lart, në pamundësi të zbatimit të mekanizmit të skemës së delegimit dhe transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor zbatimin e vendimit të tij “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Më konkretisht, në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin IV, pika 5, të këtij vendimi të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe në zbatim të paragrafit VI, pika 4, të tij, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, nder të tjera, i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët për gjykimin e 21 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Apelit Korçë, Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Posaçme e Apeli për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar. Numri i gjyqtareve që duhet të caktohen për gjykimin e 21 çështjeve të ishte 8, nga të cilët 2 nga Gjykata Apelit Korçë, 3 nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe 3 nga Gjykata e Posaçme e Apeli për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar.

Propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pranuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku mbi këtë bazë është zhvilluar procedura e shortit ndër të tjera edhe për përzgjedhjen e 1 gjyqtari me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë dhe Gjykatës së Apelit Vlorë, ndër to ato edhe për çështjen nr. 5 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, përmes shortit është përzgjedhur gjyqtari Olsi Xhavella i Gjykatës së Apelit Korçë.

Mbi këtë bazë, me Vendimin Nr.30, datë 21.01.2020, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Gjirokastër”, pika 5, Këshilli i Lartë Gjyqësor, nder të tjera, ka vendosur: “5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë, Olsi Xhavella, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Mashttrim i kryer në bashkëpunim”.

Mbas njoftimit të këtij vendimi, Kryetari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë me shkresën nr. 102 prot., datë 30.01.2020 ka bërë me dije se sa i përket gjyqtarit Olsi Xhavella të Gjykatës së Apelit Korçë, në gjykimin e çështjes penale si më lart, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk ishte mbajtur parasysh se gjyqtari në fjalë ishte caktuar më parë në gjykimin e kësaj çështjeje dhe aktualisht është anëtar i trupit gjykues.

Gjithashtu, kryetari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë ka bërë me dije se në vendimin e Këshillit ishte shënuar gabim mbiemri i të pandehurit, duke kërkuar korrigjimin e këtij gabimi në shkrim sa i përket mbiemrit të pandehurit {...} nga {...} në {...}. Nga shqyrtimi i materialit pikërisht shkresës nr. 44, datë 15.01.2020 të kryetarit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë rezulton të jetë bërë prezent fakti se për çështjen penale që kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, në përbërje të trupit gjykues ishin caktuar gjyqtarët Olsi Xhavella dhe Etleva Temo të Gjykatës së Apelit Korçë.

Ndërkohë, një fakt i tillë ishte evidentuar edhe në relacionin e përgatitur në atë rast nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Por pavarësisht kësaj, një rrethanë e tillë, pra pasja pengese ligjore për t'u përfshirë në shortimin e çështjes penale si më lart të gjyqtarit Olsi Xhavella, rezulton të mos jetë patur parasysh nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në procedurat e shortit, bazuar në rezultatin e të cilit është marrë vendimi nr.30, datë 21.01.2020, paragrafi I, nënndarja "Gjykata e Apelit Gjirokastrë", pika 5, përmes të cilit gjyqtari Olsi Xhavella është caktuar sërish për gjykimin e të njëjtës çështjeje penale.

Në këto kushte, bazuar në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 99 të Ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", është vendi për ndryshimin e pikës 5, të nënndarjes "Gjykata e Apelit Gjirokastrë", të paragrafit I, të vendimit nr.30, datë 21.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sa i përket gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjes penale si më lart.

Lidhur me gjyqtarin që duhet të caktohet për gjykimin e asaj çështjeje gjyqësore të veçantë, duke konsideruar propozimet e pranuar në mbledhjen e datës 21.01.2020, sa i përket gjykatës nga duhet të caktohet gjyqtari, pra Gjykata e Apelit Vlorë, mbetet që për

gjykimin e çështjes penale si më lart gjyqtari që duhet të caktohet, të përzgjidhet me short midis gjyqtarëve të kësaj gjykate (Gjykatës së Apelit Vlorë).

Në lidhje me sa Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka kërkuar për korrigjimin e gabimit në shkrim të bërë në Vendimin nr.30, datë 21.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sa i përket mbiemrit të të pandehurit nga “{...}” në “{...}”, nisur nga sa rezulton nga aktet, është vendi për korrigjimin e këtij gabimi, bazuar në pikën 1, të nenin 112, të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit “Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ”.

Ndërkohë, sipas pikës 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”.

Sa me sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Ndryshimin e pjesshëm dhe korrigjimin e gabimit në shkrim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 21.01.2020, “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Gjirokastrë, pika 5, si më poshtë: “5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, (që duhet ta përzgjedhim me short), caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}, etj.; Akuza: “Mashttrim kryer në bashkëpunim”. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Nëse jeni dakord me propozimin do të duhet të procedojmë me shortin.

**Naureda Llagami:** Dakord me propozimin?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

**Ilir Toska:** Meqenëse Këshilli është dakord me propozimin e Komisionit do të duhet të zhvillojmë një procedurë shorti, për caktimin e 1 gjyqtari nga Gjykata e Apelit Vlorë, për çështjen penale në nevoje në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

**Valbona Bako:** Atëherë gjyqtari i përzgjedhur - Nazmi Troka.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllet procedura e shortit, do të duhet që kryetarja të evidentojë faktin në propozim.

**Naureda Llagami:** Atëherë Këshilli vendosi: “Ndryshimin e pjesshëm dhe korrigjimin e gabimit në shkrim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 21.01.2020, “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Gjirokastrë, pika 5, si më poshtë: “5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}, etj.; Akuza: “Mashttrim kryer në bashkëpunim”.

Një kopje e vendimit i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbajtur, më 20.02.2020)*

***Pika 6 e rendit të ditës me objekt:*** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:06 dhe mbaroi në orën 14:27.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj*** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Alsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Enida Muceku, Specialiste pranë Sektorit të Suportit të Menaxhimit të Çështjeve. (dy pikat e fundit)*
- 11. Helios Reveli, EURALIUS.*
- 12. Rezart Alija, EURALIUS.*
- 13. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.



*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen e fundit të rendit, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”. Fjalën sërish ia jap zotit Toska.

*Ilir Toska:* Atëherë është përgatitur relacioni për 20 gjykata për të cilat kanë paraqitur kërkesë për caktim gjyqtari për çështje të ndryshme gjyqësore nga gjykata të tjera të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Nuk është përgatitur relacion për kërkesat që ka paraqitur Gjykata e Apelit Korçë, marrë shkas nga fakti që Komisioni më herët kishte bërë një propozim lidhur me përcaktimin për një periudhë, për komandimin fillimisht të gjyqtarës {...} në skemë delegimi dhe më tej për caktimin e saj për një periudhë deri më 15 shtator të vitit 2020 pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

Marrë shkas nga rrethana e re, shumë shpejt Komisioni do të sjell dhe një propozim sa i përket 15 çështjeve për të cilat Gjykata e Apelit Korçë mbetet në nevojë për caktimin e 1 ose 2 gjyqtarëve, duke e konsideruar tashmë faktin e komandimit të gjyqtarës {...} dhe caktimit të saj për një periudhë të caktuar kohore pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

Po kështu ju bëj me dije se është edhe një kërkesë e Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar të cilën do duhet të konsiderojmë në vijim krahas problematikës që ka paraqitur, mbas fillimit të funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsion dhe Krimin të Organizuar.

Viojmë atëherë me çështjet në nevojë të 20 gjykatave për të cilat Komisioni ka përgatitur dhe relacionet respektive.

Fillimisht Komisioni propozon për radhën e procedurës të shortit sipas gjykatave. Propozimi është që procedurat e shortit ndiqen sipas këtij rendi: Fillimisht gjykatat e apelit sipas kësaj radhe: Fillimisht gjykata e apelit në juridiksion të përgjithshëm, konkretisht Gjykata e Apelit Gjirokastrë, Gjykata e Apelit Vlorë, Gjykata e Apelit Shkodër, Gjykata e Apelit Durrës dhe në fund Gjykata e Apelit Tiranë.

Më pas vijojmë me çështjet në nevojë në Gjykatën Administrative të Apelit.

Më pas të vijoje procedurat e shortit për Gjykatat e Shkallës së Parë: fillimisht për Gjykatën e Shkallës së Parë sipas juridiksionit të Gjykatave të Apelit me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht për Gjykatën e Shkallës së Parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Më pas Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Më pas gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, fillimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, më pas ajo e Përmetit dhe në fund Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Më tej procedurat e shortit do të vijoje me gjykatën e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Më tej të vijoje procedurat për gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër, fillimisht për Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe në fund Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Dhe më tej procedurat e shortit d të vazhdojë për gjykatat e shkallës së parë nuk juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë e cila është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Së fundit procedura e shortit të vijoje me gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ, që është vetëm Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Nëse jeni dakord më këtë propozim të komisionit?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Atëherë meqenëse Këshilli është dakord me propozimin e Komisionit për radhën e procedurave të short sipas gjykatave, vijoje me gjykatën e parë, që është **Gjykata e Apelit Gjirokastrë**. Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka paraqitur nevojë në 21 çështje nga të cilat 15 çështje janë në lëndë civile dhe 6 çështje janë në lëndë penale.

Në këtë rast është e pamundur zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarit, për shkak se vetëm në ditën e sotme ne pranuar në skemë delegimi 1 gjyqtar por dhe atë, gjyqtaren znj. {...}, e caktuar për një periudhë kohe pranë Gjykatës së Apelit Korçë, në kushtet e qenies jashtë funksionit të kësaj gjykate, kështu që do duhet të konsiderojmë zbatimin e mekanizmit të caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, sa kohë është e padobishme zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit.

Referuar vendimit të tij “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjedhur me short për shqyrtimin e 21 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar. Numri i gjyqtarëve që duhet caktuar për gjykimin e 21 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 7, nga të cilit 3 nga Gjykata e Apelit Tirane, 3 nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe 1 nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, propozimet vijuese të Komisionit janë si vijon, për 12 çështjet e para civile ato nga 1 deri në 12 si dhe për çështjen civile nr.14 për të cilat kërkohet nga 1 dhe 2 gjyqtarë të caktohen 3 të tillë të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Për çështjet penale nr. 20 dhe 21 për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë ato të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, në këtë rast një gjyqtar nuk mund të jetë relator në dy çështje.

Për çështjen civile nr.13 dhe 15 si dhe për çështjet penale nr. 16, 17 dhe 19 për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar dhe 2 gjyqtarë të përzgjidhen me short nga Gjykata e Apelit Vlorë të caktuar sipas pikës 2.

Për çështjen penale nr. 18 për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar.

Propozimet e tjera Komisioni ka edhe për sa i përket përjashtimeve nga shorti, konkretisht të përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të gjykatave të apelit Vlorë, Tiranë dhe të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që janë z. Ridvan Hado, Iliba Bezati dhe Nertina Kosova.

Po kështu të përjashtohen nga shorti dy gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë me leje afatgjatë nga ish-Këshilli i Lartë Gjyqësor znj. Evjeni Sinojmeri dhe zoti Gjini Gjoni.

Në shortimin e çështjes civile nr. 13 të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështje, konkretisht: z. Sokol Ngresi dhe z. Petrit Aliaj.

Ndërsa në shqyrtimin e çështjes penale nr.18 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht: nj. Albana Boksi.

Nëse jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Atëherë, meqenëse Këshilli është dakord me propozimet e Komisionit, vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

**Valbona Bako:** Sipas propozimit të parë të Komisionit, për çështjen nr. 3 në tabelë gjyqtarja e përzgjedhur është Elona Toro.

Për çështjen nr. 12 gjyqtarja Elbana Lluri.

Për çështjen nr. 10 gjyqtarja Flutura Skënderi.

Për çështjen nr. 1 gjyqtarja Elona Toro.

Për çështjen nr. 5, Elbana Lluri.

Për çështjen nr. 7 është gjyqtarja Flutura Skënderi.

Për çështjen nr. 14 gjyqtaret Elona Toro dhe Elbana Lluri.

Për çështjen nr. 2 gjyqtare Flutura Skënderi.

Për çështjen nr. 4 gjyqtare Elona Toro.

Për çështjen nr. 6 gjyqtarja Elbana Lluri.

Për çështjen nr. 11 gjyqtarja Flutura Skënderi.

Për çështjen nr. 8 gjyqtarja Elona Toro.

Për çështjen nr. 9 gjyqtarja Elbana Lluri.

Sipas propozimin nr. 2 dhe nr. 3 në relacion, rezulton se për çështjen nr. 13 është përzgjedhur gjyqtar Hysen Saliko.

Për çështjen nr. 15 gjyqtarët Sokol Ngresi dhe Petrit Aliaj.

Për çështjen nr. 20 është gjyqtari Sokol Ngresi (relator) dhe anëtarë Petrit Aliaj dhe Hysen Saliko.

Për çështjen nr. 21, relator Petrit Aliaj dhe anëtarë Sokol Ngresi dhe Hysen Saliko.

Për çështjen nr. 19 gjyqtari Sokol Ngresi.

Për çështjen nr. 17 gjyqtari Petrit Aliaj.

Për çështjen nr. 16 gjyqtari Hysen Saliko.

Për propozimin e fundit, për çështjen nr. 18 përzgjidhet gjyqtari Dhimitër Lara.

***Ilir Toska:*** Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Gjirokastër.

Vazhdojmë procedurat e shortit për **Gjykatën e Apelit Vlorë**. Gjykata e Apelit Vlorë ka identifikuar nevojë për 11 çështje, nga të cilat 7 çështje civile dhe 4 çështje penale. Edhe në këtë rast është i pamundur zbatimi i mekanizimit të skemës së delegimit si dhe është i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm zbatimi i mekanizimit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 11 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 11 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 7.

Propozimet vijuese, propozimet kryesore janë: Për çështjet civile nr.1, nr.2 dhe nr.3, si dhe për çështjet penale nr.8 dhe nr.9, për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar, të caktohen 2 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës.

Për çështjet civile nr.4, nr.5, nr.6 dhe nr.7, për të cilat kërkohet nga 1 dhe 2 (dy) gjyqtarë, të caktohen 2 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

Për çështjet penale nr.10 dhe nr.11, për të cilat kërkohen nga 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në këtë rast, një gjyqtar nuk duhet të jetë relator në të dyja çështjet.

Propozimet e tjera të Komisionit janë sa i përket përjashtimeve nga shorti. Propozohet të përjashtohet nga shorti kryetarët në detyrë të Gjykatës së Apelit Durrës dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht zoti Desart Avdulaj dhe zonja Nertina Kosova.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër që është anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konkretisht zonja Miranda Andoni.

Në shortimin e çështjes civile nr. 2 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës që është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht zoti Izet Dushaj.

Në shortimin e çështjes civile nr.3 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht: z.Izet Dushaj, znj.Anita Mici

Në shortimin e çështjes civile nr.4 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër që janë caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht: z.Izet Salaj dhe znj.Irena Brahimi.

Së fundi, Komisioni ka edhe një propozim për mos përjashtim nga shorti të kryetarit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, zoti Dritan Banushi, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë të numrit të kufizuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate.

Nëse jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Atëherë, vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

**Valbona Bako:** Atëherë, sipas propozimit të parë, për çështjen nr. 3 gjyqtari i përzgjedhur është Tritan Hamitaj.

Për çështjen nr. 2 Anita Mici.

Për çështjen nr. 1 Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 9 Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 8 gjyqtarja Anita Mici.

Ndërsa sipas propozimit të dytë, për çështjen nr. 4 përzgjidhet gjyqtari Dritan Banushi.

Për çështjen nr. 6 janë gjyqtarët Izet Salaj dhe Dritan Banushi.

Për çështjen nr. 7 Izet Salaj dhe Dritan Banushi.

Si dhe për çështjen nr. 5 Izet Salaj dhe Dritan Banushi.

Për propozimin e fundit, për çështjen nr. 11 përzgjidhen gjyqtarët Albana Boksi (relatorë) dhe anëtarë Dhimitër Lara dhe Sokol Binaj.

Për çështjen nr. 10 Dhimitër Lara (relator) dhe anëtarë Albana Boksi dhe Sokol Binaj.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Vlorë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Shkodër**. Gjykata e Apelit Shkodër ka paraqitur nevojë në 7 çështje, nga të cilat 5 në lëndë civile dhe 2 në lëndë penale.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit të gjyqtarit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm mekanizmi për caktim gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në

mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Durrës.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4.

Në opsion të pranimit të këtij propozimi, propozimet vijuese të Komisionit janë: Për çështjet civile nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.5, për të cilat kërkohen 1 dhe 2 gjyqtarë, të caktohen 2 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Për çështjen civile nr.4, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës.

Për çështjet penale nr.6 dhe nr.7, për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Propozimet e tjera të Komisionit janë sa i përket përjashtimeve nga shorti, konkretisht të përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: z.Ridvan Hado dhe z.Desart Avdulaj

Të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë me leje afatgjatë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë: znj. Evjeni Sinojmeri dhe z. Gjin Gjoni.

Po kështu të përjashtohen nga shorti 3 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që do të caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, që rezultuan të ishin znj. Elona Toro, znj. Flutura Skënderi dhe znj. Elbana Lluri.

Në shortimin e çështjes civile nr. 4 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës që janë caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht gjyqtarët: z.Izet Dushaj dhe znj.Anita Mici.

Jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*



Meqenëse Këshilli është dakord me propozimet, vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

**Valbona Bako:** Sipas propozimit të parë, për çështjen nr. 2 janë gjyqtarët Artur Gaxha dhe Gramoz Levanaj.

Për çështjen nr. 3 Artur Gaxha dhe Gramoz Levanaj.

Për çështjen nr. 5 gjyqtari Artur Gaxha.

Për çështjen nr. 1 Gramoz Levanaj dhe Artur Gaxha.

Për çështjen nr. 4 përzgjidhet gjyqtari Valbon Çekrezi.

Për çështjen nr. 6 dhe nr. 7 përzgjidhet gjyqtari Alaudin Malaj.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Shkodër.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Durrës**. Gjykata e Apelit Durrës ka paraqitur nevojë në 2 çështje që janë në lëndë civile.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizimi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 sepse një çështje ka nevojë për 2 gjyqtarë.

Në opsionin e pranimit të këtij propozimi, Komisioni ka vetëm një propozim sa i përket përjashtimit nga shorti që është përjashtimi i kryetarit të Gjykatës së Apelit Shkodër, z. Astrit Kalaja.

Nëse jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë atëherë, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

**Valbona Bako:** Për çështjen nr. 2 gjyqtarët janë Aleks Nikolli dhe Lindita Hoxha.

Ndërsa për çështjen nr. 1 është gjyqtari Aleks Nikolli.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Durrës.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Tiranë**. Gjykata e Apelit Tiranë ka paraqitur nevojë në një çështje në lëndë civile. Kërkohej 1 gjyqtar.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Korçë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Ka propozim për përjashtim nga shorti vetëm për kryetaren në detyrë të Gjykatës së Apelit Korçë, znj. Etleva Temo. Përveç faktit që zonja Etleva Temo është në përbërje të trupit gjykues që po gjykon këtë çështje në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Jeni dakord me propozimin?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Atëherë, vazhdojmë.

**Valbona Bako:** Olsi Xhavella.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Tiranë.

Vazhdojmë me **Gjykatën Administrative të Apelit**. Ka paraqitur nevojë për një çështje. Kërkohej 1 gjyqtar.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i

gjyqtarëve të jetë 1.

Në këtë rast, të përjashtohet nga rasti, janë propozimet e tjera të Komisionit, kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, zoti Ridvan Hado dhe dy gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë me leje afatgjatë nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, znj. Evjani Sinojmeri dhe z. Gjin Gjoni. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Meqenëse Këshilli është dakord, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

**Valbona Bako:** Për çështjen nr. 1 përzgjidhet gjyqtari Hasim Vokshi.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Tiranë.

Vazhdojmë me gjykatat e shkallës së parë, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.** Ka paraqitur nevojë në dy çështje në lëndë penale.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizimi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Në opsionin e pranimit të këtij propozimi, Komisioni ka edhe propozimin vijues që ka të bëjë se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë (*lapsus, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë*) nga duhet të përzgjidhen 3 gjyqtarët të jenë nga Seksioni Penal për Çështjet e Penale të Themelit.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet të përjashtohet kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. Petrit Çomo. Po kështu të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e Seksionit Penal për Çështjet e Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë caktuar më herët në vitin 2020 në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: z. Bedri Qori dhe z.

Kreshnik Omari.

Jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik meqenëse Këshilli është dakord me propozimin.

**Valbona Bako:** Për çështjen nr. 1 përzgjidhen gjyqtarët Kastriot Gramshi dhe Migena Laska. Ndërsa për çështjen nr. 2 përzgjidhet gjyqtarja Ardiana Bera.

**Ilir Toska:** Në seksionin e çështjeve të themelit nuk është zonja Laska.

Në seksionin e çështjeve penale të themelit janë këta gjyqtarë (i keni në relacion): Petrit Çomo; Arben Mickaj; Gerd Hoxha; Kreshnik Omari; Shefkije Demiraj; Ardiana Bera; Bedri Qori; Vjollca Spahiu; Ahmet Metalia; Sokol Pasho dhe Kastriot Gramshi.

Është edhe Migena atëherë?

Unë kam pasur një informacion më herët.

Është përfshirë!

Okej atëherë, kush ishte rezultati i shortit?

**Valbona Bako:** Edhe një herë, për çështjen 1 Kastriot Gramshi dhe Migena Laska. Ndërsa për çështjen nr. 2 Ardiana Bera.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat**. Ka paraqitur nevojë në 2 çështje që janë të dyja në lëndë civile.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit të gjyqtarit, dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizimi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër.

Numri i gjyqtarëve për gjykimin e këtyre 2 çështjeve, të jetë 2.

Në këtë rast kemi propozim vetëm për përjashtimin nga shorti të kryetarit në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, z. Edvan Veçani, po ashtu kemi propozim për përjashtim nga shorti edhe të gjyqtarës së kësaj gjykate, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, znj. Nertila Kape, pasi sipas informacioneve të mbërritura më parë pranë Këshillit, ajo nuk është paraqitur në detyrë për një periudhë të gjatë kohore për arsye shëndetësore.

Jeni dakord me propozimet?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë atëherë, meqenëse Këshilli është dakord, vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

**Valbona Bako:** Për çështjen nr. 2 gjyqtari Xhevdet Lika. Ndërsa për çështjen nr. 1 gjyqtari Ardit Kuka.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka paraqitur nevojë në 2 çështje në lëndë penale dhe kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Kërkesat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë janë bërë në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk kishte caktuar në pozicion magjistratët e emëruar më datë 09.01.2020. Për rrjedhojë, kërkesat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, aktualisht nuk ekzistojnë më, pasi Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.44, datë 29.01.2020, ka caktuar në pozicion pranë kësaj gjykate gjyqtaren Elisabeta Gjoni.

Në këto kushte, kërkesat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë kanë mbetur pa objekt, prandaj është vendi që Këshilli i Lartë të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative.

Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Atëherë, vendimi i Këshillit është për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për

caktimin e 1 gjyqtari, si vijon:

Kërkesë nr.42/894 prot., datë 24.01.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria Krujë, me objekt: “Pushim i procedimit penal, etj.”;

Kërkesë nr.19 prot., datë 24.01.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me kërkues: Petrit Doçi, me objekt: “Përjashtim gjyqtari”.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje në lëndë civile. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, duke qenë kështu i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 saç është edhe nevoja.

Propozimi i vetëm është për përjashtim nga shorti të kryetares në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, znj. Entela Shedula.

Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

**Valbona Bako:** Për çështjen nr. 130 është përzgjedhur gjyqtari Genti Dokollari.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka paraqitur nevojë në 1 çështje në lëndë penale. Kërkohet 1 gjyqtar, por që duhet të jetë nga seksioni i të miturve.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 saç është nevoja.

Kemi vetëm një propozim për mos përjashtim nga shorti të kryetarit në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, z. Dritan Hasani, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe të numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Vazhdojmë atëherë procedurat e shortit elektronik.

**Valbona Bako:** Atëherë, për çështjen nr. 1 përzgjidhet gjyqtari Dritan Hasani.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet**. Ka paraqitur nevojë në 4 lëndë penale.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 4 çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 5.

Në opsionin e pranimit të këtij propozimi, propozimet vijuese të Komisionit janë:

Për çështjen nr.4, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Për çështjet nr.1, nr.2 dhe nr.3, për të cilat kërkohen 1 gjyqtar, të caktohen 2 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, të ndryshëm nga ata të caktuar sipas pikës 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti kemi këto propozime:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që mund të caktohet për të gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Që rezultoi në fakt që nuk është caktuar një i tillë, për sa kohë u caktua gjyqtari Dritan Hasani i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Propozimi tjetër ka të bëjë me përjashtimin nga shorti në çështjen nr.4 të gjyqtarit e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, të cilët kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: z.Sokol Pina, znj.Nevrie Duka, z.Arben Dosti, znj.Blerta Çibuku, z.Pëllumb Vehbi.

Në shortimin e çështjeve nr.1, nr.2 dhe nr.3 të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që do të caktohen për të gjykuar çështjen nr.4.

Në shortimin e çështjeve nr.1, nr.2 dhe nr.3 të përjashtohet nga shorti kryetarët në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, konkretisht: z.Arben Dosti dhe z.Sokol Pina.

Jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Meqenëse Këshilli është dakord, vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

**Valbona Bako:** Atëherë, për propozimin e parë të Komisionit, për çështjen nr. 4,



përzgjidhen gjyqtarët Suela Xhani (relatore) dhe anëtarët Mirela Kore Iliopulli (anëtare) dhe Shkëlzen Liçaj (anëtar).

Ndërsa për propozimin e dytë, për çështjen nr. 1 përzgjidhet gjyqtarja Suela Dashi.

Për çështjen nr. 2 gjyqtarja Blerta Çibuku.

Dhe për çështjen nr. 3 përzgjidhet gjyqtarja Suela Dashi.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje që është në lëndë penale. Kërkohet 1 gjyqtar.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, duke qenë kështu i aplikueshëm mekanizimi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për 1 çështje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në këtë rast kemi një propozim për përjashtim nga shorti të kryetarit në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, zotit Arben Dosti, si dhe të përjashtohen nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë që kanë pengesë ligjore për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht z. Pëllumb Vehbi dhe Mirela Iliopulli.

Jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik meqenëse Këshilli është dakord.

**Valbona Bako:** Atëherë, për çështjen nr. 1 përzgjidhet gjyqtarja Blerta Çibuku.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë**. Ka paraqitur nevojë në 2 çështje (1 në lëndë civile dhe 1 në lëndë penale).

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Në rast të pranimit të këtij propozimi, propozimet vijuese janë për çështjen civile nr. 1 për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Për çështjen penale nr.2, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet, me short, nga gjyqtarët e Seksionit Penal po të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, Komisioni ka këto propozime:

Në shortimin e çështjes civile nr.1 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier që ka paraqitur kërkesë për përjashtimin nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër të ndryshme, nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, kërkesë që është në proces shqyrtimi, konkretisht: znj.Marsela Dervishi.

Ndërsa në shortimin e çështjes penale nr.2 të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, konkretisht: znj.Matilda Shalla.

Jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Atëherë, meqenëse Këshilli është dakord, vijojmë me shortin elektronik.

**Valbona Bako:** Atëherë, për çështjen e parë civile, përzgjidhet gjyqtari Ergys Selmani.

Ndërsa për çështjen e dytë penale përzgjidhet gjyqtari Piro Sota.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë**. Ka paraqitur nevojë në 3 çështje që janë në lëndë penale.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit të gjyqtarëve dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4.

Në opsion të pranimit të këtij propozimi, propozimet vijuese të Komisionit janë:

Për çështjen nr.1, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Për çështjet nr.2 dhe nr.3, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, Komisioni ka propozime që të përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, konkretisht zoti Arbër Çela dhe zoti Erjon Çela.

Jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Meqenëse Këshilli është dakord vijojmë me procedurat e shortit elektronik.

**Valbona Bako:** Për çështjen nr. 1 përzgjidhet gjyqtari Sokol Shehu. *(Rihidhet shorti).*

Atëherë, për çështjen nr. 1 që kërkon 3 gjyqtarë, përzgjidhen gjyqtarët Luveda Dardha (relatore) dhe anëtarët Tonin Stërkaj dhe Besmir Stroka.

Ndërsa për çështjen nr. 2 dhe 3 përzgjidhet gjyqtari Sami Ujkashi.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka paraqitur nevojë në 1 çështje penale.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, Komisioni ka vetëm një propozim: të përjashtohet nga shorti gjyqtari Ali Koleci që ka paraqitur kërkesë për daljen në pension të parakohshëm, kërkesë e cila është në proces trajtimi. Ndërkohë të përjashtohet nga shorti edhe kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, z. Artan Çupi. Pra të ketë dy përjashtime.

Jeni dakord me këto propozime?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë atëherë, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

**Valbona Bako:** Gjyqtari i përzgjedhur është Rexhep Karaj.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka paraqitur nevojë në një çështje në lëndë penale.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit të gjyqtarit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Kemi vetëm një propozim për përjashtim nga procedurat e shortit, të kryetares në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, znj. Alma Ahmeti Zhupa.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Meqenëse Këshilli është dakord, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

**Valbona Bako:** Për çështjen nr. 1 përzgjidhet gjyqtarja Merita Karaj.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje në lëndë civile. Kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është bërë në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk kishte caktuar në pozicion magistratët e emëruar më datë 09.01.2020.

Për rrjedhojë, nevoja si më lart e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër aktualisht nuk ekziston më, pasi Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.46, datë 29.01.2020, ka caktuar në pozicion pranë kësaj gjykate gjyqtaren Kostandina Kuro.

Në këto kushte, bazuar në nenet 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni propozon që Këshilli të vendosë deklarinimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës nr.85, datë 23.01.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për caktimin e një gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore

që iu përket palëve: paditës: Merxhan Qerimaj; të paditur: Kole Shiroka, etj.; persona të tretë: Rita Laca etj.; objekti: “Shpalljen e falsitetit të vendimit nr.1600, datë 27.09.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Bashkia Shkodër dhe anulimin e këtij vendimi, etj”.

Jeni dakord me këtë?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë atëherë, ky propozim i Komisionit u miratua pasi Këshilli është dakord.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec**, e cila ka paraqitur nevojë në një çështje në lëndë penale. Është kërkuar në datë 27 janar 2020 caktimi i dy gjyqtarëve.

Siç përmenda, me shkresën nr. 12 prot., datë 27 janar 2020 është kërkuar caktimi i dy gjyqtarëve me arsyetimin se çështja penale për të cilën ishte në nevojë kërkonte tre gjyqtarë dhe trupi gjykues kishte vetëm 1 gjyqtar në atë rast znj. Emona Muçi.

Ndërkohë, me informacionin e dërguar ditën e djeshme rezulton që nevoja në fakt në këtë çështje të rezultojë vetëm në 1 gjyqtar, për shkak se referuar vendimit të dërgimit të çështjes në gjyq, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec në atë rast kishte referuar gabim dispozitën nga neni 283/1 që ishte në fakt akuza e ngritur nga organi i prokurorisë, në vendimin e gjykatës është referuar neni 283/2 i Kodit Penal. Ky vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec më pas është ndrequr po nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe në informacionin e dërguar ditën e djeshme nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec është bërë me dije se është ndrequr dispozita në të cilën është akuzuar i pandehuri në atë rast dhe i referohet nenit 283/1 të Kodit Penal, dispozitë kjo, vepra penale për të cilën kërkon një trup gjykues të përbërë nga gjyqtar i vetëm.

Në këto kushte, rezulton që nevoja e paraqitur sipas kërkesës së datës 27 janar 2020 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec të mos ekzistojë më, prandaj Këshilli bazuar në nenin 90 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative duhet të vendosë deklarinimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës nr. 12 prot, datë 27.01.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për caktimin e dy gjyqtarëve në çështjen gjyqësore që i përket palëve: kërkuar: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Pogradec; i pandehur: {...}; akuza: neni 283/2, korrigjuar neni 283/1 i Kodit Penal, me vendimin nr. {...}, datë 23.01.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Jeni dakord me këtë propozim?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë atëherë, Këshilli miratoi këtë propozim të Komisionit.

Vazhdojmë dhe me gjykatën e fundit që është **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**. Ka paraqitur nevojë në 1 çështje. Kërkohej 1 gjyqtar.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizimi i skemës së delegimit të gjyqtarit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizimit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, duke qenë i aplikueshëm mekanizimi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Në këtë rast kemi vetëm një propozim për përjashtim nga shorti të kryetarit të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Korçë, z. Sokol Ibi.

Jeni dakord me këtë?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Meqenëse Këshilli është dakord, vazhdojmë me procedurat e shortit elektronik.

**Valbona Bako:** Për këtë çështje përzgjidhet gjyqtari Ligoraq Toshi.

**Ilir Toska:** Me kaq mbyllen të gjitha procedurat e shortit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska.

Me kaq po e mbylлим edhe mbledhjen e ditës së sotshme.

Faleminderit!

Mirupafshim!

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**